



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/154  
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për fushën e Mbikëqyrjes së Tregut të Produkteve.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship and Trade*

---

## KONCEPT DOKUMENT

## PËR FUSHËN E MBIKËQYRJES SË TREGUT TË PRODUKTEVE

*Korrik 2023*

## Përmbajtja

<b>Përmbledhje e koncept dokumentit .....</b>	<b>3</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>8</b>
<b>Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....</b>	<b>11</b>
1.1. Arsyet për ndryshimet e nevojshme .....	15
1.2 Niveli aktual i harmonizimit të legjislacionit vendor me Bashkimin Evropian.....	19
1.3 Publikimi i Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet.....	24
1.4 Ligji për Kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit shumë i ngushtë për t'u përdorur për transpozimin e Rregulloreve (BE) 2019/1020 dhe 2019/515 .....	26
1.5 Nevoja për themelimin e njërive të reja organizative dhe përgatitjet të hyrë në sistemet horizontale të BE-së .....	27
<b>Kapitulli 2: Objektivat .....</b>	<b>30</b>
<b>Kapitulli 3: Opsionet.....</b>	<b>31</b>
3.1: Opcioni 1-"Pa ndryshime" .....	31
3.2: Opcioni 2 - Miratimi i Ligjit të ndryshuar për Kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësim të konformitetit dhe përmirësimi i zbatimit të tij .....	32
3.3: Opcioni 3 - Miratimi i Ligjit të ri për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve .....	33
<b>Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen .....</b>	<b>36</b>
4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave .....	38
<b>Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....</b>	<b>39</b>
<b>Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve.....</b>	<b>41</b>
6.1: Krahasimi i tri opsioneve .....	41
6.2. Plani i zbatimit për opsionin e preferuar .....	42
<b>Kapitulli 7: Përfundimi dhe hapat e ardhshëm .....</b>	<b>47</b>
7.1: Dispozitat për monitorim dhe vlerësim.....	47
<b>Aneksi 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik.....</b>	<b>48</b>
<b>Aneksi 2: Formulari i vlerësimit të ndikimeve sociale .....</b>	<b>51</b>
<b>Aneksi 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit mjedisor .....</b>	<b>55</b>
<b>Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit në të drejtat themelore.....</b>	<b>58</b>

## Përmbledhje e koncept dokumentit

Informata të përgjithshme	
Titulli	<b>Koncept dokumenti për fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve</b>
Ministria përgjegjëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	Gurakuq Kastrati <a href="mailto:gurakuq.kastrati@rks-gov.net">gurakuq.kastrati@rks-gov.net</a>
PSO	Koncept dokumenti është pjesë e Planit Strategjik Operacional
Prioritet strategjik	<p>- <b>Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2022-2026</b>, Blloku 3:3.1.Kapitulli 1: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-in e BE-së;</p> <p><i>Objektivat prioritare afatmesme:</i> Transpozimi i Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave në legjislacion primar (<b>Hartimi i Ligjit të ri për Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve</b>).</p> <p>- <b>Konkluzionet e takimit të Nën komitetit të MSA Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime për Kosovën 2022 i Komisionit Evropian:</b> Miratimi i Koncept Dokumentit për fushën e mbikëqyrjes se tregut të produkteve;</p> <p>- <b>PRE 2022-2024: Masa e reformës #13: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut: a.7-</b> Hartimi i koncept dokumentit për mbikëqyrjen e tregut dhe pajtueshmërinë e produkteve, si dhe për njohjen reciproke të mallrave që tregtohen.</p>

Vendimi	
Çështjet kryesore	Marrë për bazë reformën ligjore në BE me të cilën Rregullorja (BE) 2019/1020 e zëvendësoi Rregulloren (KE) 765/2008 në pjesën që lidhet me mbikëqyrjen e tregut të produkteve, me qëllim të përmirësimit dhe modernizimit të sistemit të mbikëqyrjes ekzistuese të tregut të produkteve me të cilën janë eliminuar mangësitë dhe problemet ekzistuese, paraqesin nevojën e domosdoshme për hartimin dhe

	<p>miratimin e Ligjit për Inspektimin e përputhshmërisë së produkteve<sup>1</sup>. Mungesa e dispozitave në legjislacionin aktual lidhur me detyrat e operatorëve ekonomik, shitjet në distancë (online), kërkesa të reja për përputhshmërinë e produkteve me standardet e harmonizuara, themelimi i një zyre të vetme ndërlidhëse për koordinimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut, ngritja e një sistemi për informim, janë arsye tjera për të transpozuar legjislacionin e ri të BE-së.</p> <p>Ligji i ri për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve plotëson dhe do të formojë një kornizë të qëndrueshme për sigurinë dhe përputhshmërinë e produkteve, me të cilin do të rregullohen aktivitetet dhe masat e mbikëqyrjes së tregut në përputhje me ligjin nr. 08/L-067 për Inspektimet, duke zëvendësuar kështu dispozitat e Ligjit 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (Kapitulli:mbikëqyrja e tregut).</p>
Përmbledhje e konsultimeve	Koncept Dokumenti është dërguar për konsultim paraprak brenda institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë periudhës 11 Janar 2023 – 11 Shkurt 2023
	Koncept Dokumenti është dërguar në konsultim publik dhe është vendosur në platformën e konsultimeve publike gjatë periudhës 03 Mars 2023 - 24 Mars 2023
Opsioni i propozuar	<p>Ky dokument rekomandon miratimin e Ligjit të ri për Inspektimet e përputhshmërisë së produkteve si opsion i preferuar për arritjen e koherencës dhe efektivitetit të legjislacionit kornizë të Republikës së Kosovës në fushën e mbikëqyrjes së inspektimit të produkteve joushqimore dhe lëvizjes së lirë të mallrave.</p> <p><b>Opsioni 3</b> është opsioni më i duhur si politikë për t'i adresuar problemet kryesore të identifikuara në këtë dokument: domethënë, mangësitë ekzistuese dhe unifikimin e nevojshëm të dispozitave për mbikëqyrjen e tregut në ligjet e Republikës Kosovës lidhur me produktet të cilat ofrojnë zgjidhje të ndryshme në lidhje me kompetencat dhe procedurat, si ligj i veçantë në përputhje me Ligjin nr. 08/L-067 për Inspektimet.</p>

### Ndikimet kryesore të pritura

Ndikimi buxhetor	<p>Do të jetë e nevojshme të sigurohen fonde shtesë nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligji në vlerë prej 60,572.00 EUR.</p> <p>Fonde shtesë janë të nevojshme për :</p>
------------------	---

<sup>1</sup> Titulli i ligjit të ardhshëm parësor propozohet të jetë “Ligji për Inspektimet e Pajtuëshmërisë së Produkteve” për të treguar që ky është ligj i veçantë sipas kuptimit të Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet

	<p>a) themelimin dhe funksionimin e Zyrës Ndërlidhëse (numrin e të punësuarve të rinj , kostot materiale) 17,786.00 EUR ,</p> <p>b) krijimin dhe funksionimin e pikës së kontaktit (numri i të punësuarve të rinj , kostot materiale ) 17,286.00 EUR,</p> <p>c) informimi i vazhdueshëm palëve të interesit dhe ngritja e vetëdijes për përputhshmërinë e produkteve, përmes punëtorive, spoteve televizive, takimeve publike 15,500.00 EUR,</p> <p>d) Hartimi i Strategjisë për Mbikëqyrjen e Inspektimit të Produkteve 10,000.00 EUR,</p>
Ndikimi ekonomik	<p>Ligji do t'i shërbejë parimit të promovimit të rritjes ekonomike të qëndrueshme, duke siguruar dhe përmirësuar qasjen e koordinuar dhe rrjedhimisht, efikase të mbikëqyrjes së tregut. Rritja e efikasitetit dhe modernizimi i sistemit të mbikëqyrjes së tregut të produkteve jep një sinjal pozitiv për ekonominë dhe ndikon drejtpërdrejtë në lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave (<i>produkte, procese dhe shërbime</i>).</p>
Ndikimi social	<p>Të drejtat e konsumatorit individual dhe familjar do të përmirësohen përmes rregullave të fuqizuara dhe zbatimit me të mirë të rregullave ekzistuese të cilat janë në nivelin e kërkuar të plotësimit të kërkesave themelore të sigurisë së produkteve në treg.</p> <p>Dispozitat e ligjit të harmonizuara me Rregulloret e BE-së 2019/1020 dhe 2019/515 janë vlerësuar për lidhjen e tyre me barazinë. Nuk ka as një disavantazh të tërthortë dhe as të drejtpërdrejtë të lidhur me gjininë. Barazia gjinore dhe faktike mes burrave dhe grave ruhet.</p>
Ndikimet mjedisore	<p>Ligji do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, pasi që do ta fuqizojë edhe mbikëqyrjen e inspektimeve mbi një sërë pjesësh të legjisllacionit të orientuara drejt mjedisit siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Direktiva 2011/65/BE për kufizimin e përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme në pajisje elektrike dhe elektronike;</li> <li>-Rregullorja (BE) Nr. 517/2014 për gazrat serrë të florizuar;</li> <li>-Rregullorja (BE) 2016/1628 për kërkesat në lidhje me kufijtë e emetimit të ndotësve të gaztë dhe grimcave dhe miratimin e tipit për motorët me djegie të brendshme për makineri të lëvizshme jo-rrugore.</li> </ul> <p>Thënë më përgjithësisht, Ligji do ta rregullojë përputhshmërinë e produkteve dhe pajisjeve të cilat vendosen në treg apo përdorim, ato duhet të jenë në përputhshëri me kërkesat e standardeve të harmonizuara në funksion të përmbushjes së kërkesave themelore, ku njëra nga to është mbrojtja e mjedisit. Kjo nënkupton,</p>

	produkte në përputhje/konformitet, të sigurta, efëiente, të riciklueshme, mbrojtje nga zhurma dhe ndotës me pak në mjedis.
Barra administrative për kompanitë	Ligji i hartuar, poashtu, do të saktësojë dhe unifikojë detyrimet e operatorëve ekonomik për disa grupe të produkteve, do të qartësojë kompetencat dhe masat e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, duke e kufizuar kështu barrën për operatorët ekonomik në zinxhirin e furnizimit. Racionalizimi i numrit të inspektimeve nga inspektoratet kompetente për grupe të caktura të produkteve në kuadër të reformës nga ligji i inspektimeve.  Barra administrative do të zvogëlohet për shkak të organizimit të përmirësuar dhe një mbikëqyrje të modernizuar dhe efikase të produkteve në treg.
Ndikimi në NVM	Ndikimi pozitiv duke rritë konkurrencën të NVM-të për shkak të organizimit të përmirësuar dhe mbikëqyrjes së fuqizuar të produkteve në treg, gjë që e kufizon vendosjen në treg të produkteve që nuk janë në përputhshmëri dhe penalizimin e operatorëve ekonomik që nuk iu përmbahen gjithmonë rregullave të marketingut.

<b>Hapat e mëtejshëm</b>	
Afatshkurtër	1. Hartimi i Ligjit për Inspektimet e përputhshmërisë së produkteve
Afatmesëm	<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i rregullores së QRK-së për grupet e produkteve dhe rregulloreve teknike që janë subjekt i mbikëqyrjes së inspektimeve në përputhje me ligjin, përfshirë autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e akteve individuale ligjore dhe grupet e ndërlidhura të produkteve;</li> <li>Hartimi i rregullores së QRK-së për grupe të përzgjedhura të produkteve që mund të vendosen në treg vetëm nëse operatori ekonomik i cili furnizon me ato produkte është i themeluar në Republikën e Kosovës;</li> <li>Hartimi i vendimit për Zyrën Ndërlidhëse si njësi e veçantë organizative e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm përgjegjëse për përfaqësimin e pozitës së koordinuar të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe Autoritetit Doganor (<i>Single liaison office</i>);</li> <li>Hartimi i Strategjisë për mbikëqyrjen e inspektimeve të përputhshmërisë së produkteve, e cila do të miratohet nga Qeveria, me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm;</li> <li>Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore të veprimit sektorial dhe planit të përgjithshëm të veprimit për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve i cili do të miratohet me qëllim të zbatimit të strategjisë për mbikëqyrjen e tregut;</li> <li>Hartimi i vendimit për themelimin e Pikës së Kontaktit për Produkte e cila themelohet nga Ministria dhe e cila do të ofrojë informacionin e nevojshëm në lidhje me kërkesat ligjore për tregtimin e produkteve;</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"><li>7. Detyra të shtuara të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut në aktivitete të përbashkëta me operatorët ekonomik dhe shoqatat e konsumatorëve;</li><li>8. Informimi i vazhdueshëm i palëve të interesit dhe ngritja e vetëdijes për përputhshmërinë e produkteve, përmes punëtorive, spoteve televizive dhe takimeve publike.</li></ol>
--	--



## Hyrje

Duke pasur parasysh detyrimet e Republikës së Kosovës nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, është e nevojshme që të gjitha organet kompetente shtetërore të përshpejtojnë aktivitetet për t'i përmbushur ato detyrime. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ndër të tjera kërkon që harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së të përqendrohet në elementët kryesore të *acquis* për tregun e brendshëm të BE-së, duke theksuar, ndër të tjera, mbrojtjen e konsumatorit, standardizimin, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut.

Arsyeja kryesore për hartimin dhe miratimin e këtij ligji është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve që përdorin produktet, si dhe përdoruesve të tjerë që i përdorin produktet për nevojat e tyre në kryerjen e veprimtarive profesionale. Ky ligj do të sigurojë një mbikëqyrje efektive të tregut për produktet e vendosura në dispozicion të tregut dhe do të parandalojë prodhimin, importin dhe vendosjen në treg të produkteve të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat themelore.

***Tabela 1: Tabela me informata të përgjithshme lidhur me Koncept Dokumentin***

Titulli	Koncept dokumenti në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve
Ministria përgjegjëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	Gurakuq Kastrati, Udhëheqës i Divizionit të Infrastrukturës së Cilësisë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
PSO	Koncept dokumenti është paraparë me Plani Strategjik Operacional
Prioritet strategjik	<ul style="list-style-type: none"><li>- <b>Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2022-2026</b>, Blloku 3: 3.1. Kapitulli 1: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me <i>Acquis-in</i> e BE-së;</li><li><i>Objektivat prioritarë afatmesme</i>: Transpozimi i Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave në legjislacion primar (Hartimi i Ligjit të ri për Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve).</li><li>- <b>Konkluzionet e takimit të Nën komitetit të MSA Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime për Kosovën 2022 i Komisionit Evropian</b>: Miratimi i Koncept Dokumentit për fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve;</li><li>- <b>Masa e reformës #13: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut: a.7-</b></li></ul>

	<p>Hartimi i koncept dokumentit për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve, si dhe për njohjen reciproke të mallrave që tregtohen në BE;</p> <p><b>- Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 (2017-2021), Nën-Objektivi 1.1</b> Reformat për legjislacionin ekzistues primar dhe sekondar për ta rritur konkurrencën.</p> <p><b>- Plani Strategjik Operacional -</b> Qellimi Strategjik 4. - Përmirësimi infrastrukturës së standardeve dhe cilësisë përfshirë mbrojtjen e konsumatorit 4.1.12. Miratimi i Koncept Dokumentit për fushën e Mbikëqyrjes së Tregut</p>
Grupi punues	<p><b>Përfaqësuesit e ministrive të linjës, agjencive ose profesioneve të mëposhtme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gurakuq Kastrati (MINT) - Udhëheqës i Divizionit të Cilësisë së Infrastrukturës - kryesues</li> <li>- Doruntina Shala Hoxha (MINT - DIC) Zëvendëse Udhëheqëse e divizionit për marrëveshje tregtare - anëtare;</li> <li>- Naim Hajra (MINT - MI) - Zëvendës i Udhëheqësit të sektorit për sigurinë e produkteve – anëtar;</li> <li>- Bujar Istogu (MINT - AKS) - Zëvendës i Drejtorit të Përgjithshëm i AKS, anëtar;</li> <li>- Mevlyde Beqiri (MINT) - Udhëheqëse Divizionit për Buxhet dhe Financa, anëtare;</li> <li>- Samire Bajraktari (MINT) - Zyrtare, Departamenti Ligjor (MINT) - anëtare;</li> <li>- Dardan Nallbani (MINT) - Zyrtar i lartë për Integritet Evropian;</li> <li>- Shkurte Krasniqi (SKQ) - Udhëheqëse e Divizionit për Rregullim me të mire, anëtare</li> <li>- Visar Bajraktari - (MINT), anëtar; Drejtoria e Akreditimit e Kosovës</li> <li>- Albana Krasniqi - (ZKM), anëtare; Zyrtare e lartë ligjore - Zyra e Kryeministrit</li> <li>- Artan Demolli - (MINT) Zyrtar i Lartë për Hartimin e Rregullave Teknike</li> </ul>
Informata shtesë	<p>Hartimi i këtij Koncept Dokumenti është përkrahur nga Projekti Lux-Dev” KSV/019 - Asistenca Teknike në Kontekstin e Integritet Evropian</p>

Marrë parasysh mundësitë për zgjidhjen e problemit të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe nevojën për harmonizim me zgjidhjet adekuate që ofrojnë një shkallë të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë të

produkteve është inicuar procedura për hartimin e këtij koncept dokumenti i cili i paraprinë një kornizë të re ligjore për këtë fushë.

Për shkak të mungesës së dispozitave në Ligjin Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësimin e Konformitetit (Mbikëqyrja e Tregut) i cili në fushëveprim nuk mbulon grupet e nevojshme të produkteve jo-ushqimore, aktivitetet dhe masat të cilat duhet të merren nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, pamundëson mbikëqyrje efektive të tregut me qëllim që të sigurohet që vetëm produktet në përputhshmëri të vihen në dispozicion në treg. Gjithashtu ky ligj nuk rregullon në tërësi përgjegjësitë për subjektet ekonomike dhe persona të tjerë juridik që përdorin produkte në kryerjen e veprimtarive të tyre, përfshirë edhe tregtinë elektronike, nga këndvështrimi i garantimit të një niveli të lartë të përmbushjes së kërkesave themelore të shëndetit dhe sigurisë. Mungesa e “zyres së vetme ndërlidhëse” për koordinimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut vështirëson bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut dhe Doganës së Kosovës të cilat janë të përfshira në kontrollin e produkteve të vëna në dispozicion në treg.

Sipas Rregullores së BE-së 2019/1020 nga 16 korriku 2021, shitësit jashtë BE-së do të duhet të kenë një përfaqësues të autorizuar në BE për të shitur produkte të konsumatorët e BE-së. Rregullorja për Mbikëqyrjen e Tregut përcakton rregullat sipas të cilave ofruesi i shërbimit të përmbushjes do të mbahet përgjegjës kur shitësi jashtë BE-së nuk cakton një person përgjegjës. Kështu, kompanitë si Amazon, ebay, aliexpres etj, do të duhet të sigurojnë që të gjithë shitësit e tyre jashtë BE-së të kenë një përfaqësues të autorizuar të themeluar brenda BE-së për të mos shmangur përgjegjësinë. Kjo politikë i mungon tregut të Kosovës

Rregullorja (BE) 2019/1020 i përmban rregullat dhe procedurat e mbikëqyrjes së tregut për 70 akte ligjore që i rregullojnë produktet jo-ushqimore të cilat përfshijnë, mes tjerash, edhe automjetet, pajisjet mjekësore, kemikatet, eksplozivët për përdorim civil dhe instrumentet matëse që nuk janë pjesë e grupeve të produkteve të përfshira në Ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Këto janë arsye për të cilat propozohet që Rregullorja e BE-së të transpozohet në një Ligj horizontal për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve.

Ligji i ri gjithashtu do të ofrojë siguri ligjore për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, pasi ai përshkruan në detaje veprimet dhe detyrimet e operatorëve ekonomik në lidhje me vendosjen në treg të produkteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve, rreziqet që mund të paraqesin produktet e tilla, si dhe aktivitetet dhe masat e marra për këtë qëllim.

Zbatimi i këtij ligji do të ndikojë ndjeshëm në parandalimin e konkurrencës së jo të drejtë, sepse rregulla të barabarta dhe të qarta do të vendosen për të gjithë operatorët ekonomik në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e produkteve. Zbatimi i ligjit të ri mund të rrisë kostot për operatorët ekonomik (analiza e rrezikut, informacioni i konsumatorit, monitorimi i tregut), këto kosto padyshim do të jenë të justifikuar dhe shumë më të ulëta se kostot e mundshme që mund të vijnë nga pasojat

e dëmtimit të shëndetit të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë, të shkaktuara nga përdorimi i produkteve të cilat nuk plotësojnë kërkesat themelore.

Grupi punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve është themeluar me vendim të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, dhe si i tillë është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve të miratuara nga Qeveria për vitin 2023.

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

### PËRSHKRIMI I POLITIKËS DHE KORNIZËS LIGJORE EKZISTUESE

*Tabela2 : Dokumentet relevante të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

Dokument i politikave, ligji ose akti nënligjor	Lidhja me dokumentin online dhe me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucionet shtetërore përgjegjëse për implementim	Roli dhe detyrat e institucionit(eve)
Marrëveshja për stabilizim dhe asociim	<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239">https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239</a>  <a href="http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_55-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf">http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_55-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf</a>	Qeveria e Kosovës dhe ministrinë  Inspektoratet dhe autoritetet tjera përmbarese  Gjyqësori	Themelimi dhe mirëmbajtja e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut  Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve  Mbrojtja gjyqësore
PKZMSA 2022-2026	<a href="https://www.mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf">https://www.mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf</a>	Qeveria e Kosovës dhe ministrinë  Inspektoratet dhe autoritetet tjera përmbarese	Identifikimi i kompetencave të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut <sup>2</sup>  Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve


<sup>2</sup> Kompetencat duhet të shpërndahen në mënyrë të unifikuar në legjislacionin kombëtar për mbikëqyrjen e tregut të produkteve

<p>Ligji nr. 08/L-067 Për Inspektimet</p>	<p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067</a></p>	<p>Qeveria e Kosovës dhe ministrinë Inspektoratet dhe autoritetet tjera përmbarese</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit,</p> <p>Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve në fushën e përcaktuar të kompetencës</p> <p>Përcaktimi i parimeve të inspektimit, Themelimi i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm,</p> <p>Rregullimi për organizimin e organeve inspektuese në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave si dhe të përcaktojë rregullat për koordinimin dhe procedurën e inspektimit.</p>
<p>Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve (i ndryshuar)</p>	<p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799</a></p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799</a></p>	<p>Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ministrinë tjera të linjës</p> <p>Inspektoratet dhe autoritetet tjera përmbarese</p> <p>Gjyqësori</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit,</p> <p>Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve në fushën e përcaktuar të kompetencës</p> <p>Mbrojtja gjyqësore</p>
<p>Ligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit</p>	<p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388</a></p>	<p>MINT dhe ministrinë tjera të linjës</p> <p>Inspektoratet dhe autoritetet tjera përmbarese</p> <p>Gjyqësori</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit,</p> <p>Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve në fushën e përcaktuar të kompetencës</p> <p>Mbrojtja gjyqësore</p>

<p>Ligji nr. 03/L-181 për Inspektoratin e tregut (i ndryshuar)</p>	<p><a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703</a></p> <p><a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703</a></p>	<p>Inspektorati i Tregut</p> <p>Gjyqësori</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit</p> <p>Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve në fushën e përcaktuar të kompetencës</p> <p>Mbrojtja gjyqësore</p>
<p>Rregullorja (QRK) nr. 24/2020 për Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese</p>	<p><a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32401">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32401</a></p>	<p>MINT dhe ministritë tjera të linjës</p> <p>Inspektoratet dhe autoritetet tjera fuqizuese</p> <p>Gjyqësori</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit</p> <p>Marrja e masave dhe shqiptimi i ndëshkimeve në fushën e përcaktuar të kompetencës për grupet e produkteve</p> <p>Mbrojtja gjyqësore</p>
<p>Plani i Veprimit: Transpozimi dhe Zbatimi i: Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores së BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave,</p>	<p><a href="https://kryeministri.rks.gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Vendimet-e-mbledhjes-se-89-te-te-Qeverise-1.pdf">https://kryeministri.rks.gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Vendimet-e-mbledhjes-se-89-te-te-Qeverise-1.pdf</a></p>	<p>MINT dhe ministritë tjera të linjës</p> <p>Inspektoratet dhe autoritetet tjera fuqizuese</p> <p>Dogana e Kosovës</p>	<p>Transpozimi i legjislacionit të BE-së.</p> <p>Vendim Nr.19/89, Dt.20.07.2022 për miratimin e Planit të Veprimit - Qeveria e Republikës së Kosovës.</p>

Të dhënat nga Inspektoriati Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut për inspektimet e realizuara gjatë tri viteve të fundit:

Gjatë vitit 2022, Inspektorati i Tregut ka realizuar gjithsej **2830 inspektime**, nga të cilat 1453 janë realizuar nga inspektorët për kontrollin e tregut të naftës, 732 janë realizuar nga inspektorët për sigurinë e produkteve, ndërsa 663 janë realizuar nga inspektorët e mbikëqyrjes së përgjithshme të tregut.



*Diagrami 1. Numri i përgjithshëm i inspektimeve*

Produktet e ndaluara nga tregu gjatë vitit 2022:

Siç edhe ishte planifikuar ne Planin e Punës, gjatë vitit 2022 fokus i IQMT-së ishte evidentimi dhe largimi nga tregu i produkteve të pa sigurta të cilat nuk plotësojnë kërkesat ligjore për qarkullim në treg, si dhe mos lejimi i produkteve që të futen në tregun e brendshëm nëse ato konsiderohen si të pasigurta përmes kontrolleve të vazhdueshme në Doganë.

Siç mund të shihet në tabelat e mëposhtme, gjatë këtij viti janë asgjësuar produkte në vlerë prej 3958 copë, meqenëse të njëjtat nuk kanë plotësuar kërkesat themelore të sigurisë dhe si të tilla ato konsiderohen të pasigurta.

<i>Produkte të asgjësuara</i>	
Gurë (disqe) për prerje të betonit dhe hekurit	2751 copë
Pajisje elektrike	535 copë
Pajisje personale mbrojtëse	300 copë
Silikon	238 copë
Lodra për fëmijë	134 copë

Gjatë vitit janë ndaluar nga tregu dhe janë kthyer në vendin e origjinës produktet e listuara në tabelën e mëposhtme. Produktet lodra (imitim i rrezikshëm i ushqimeve) janë ndaluar nga tregu pasi që të njëjtat janë të ndaluara që të vendosen në treg.

<i>Produkte të ndaluara/ larguara nga tregu</i>
---

Cement	50 ton
Punime nga metalet e çmuara	188.650 kg
Lodra	4527 copë
Pajisje elektrike	105 copë
Dezinfektues	609 copë

Gjatë kontrolleve në pikat doganore, para se produktet të vendosen në treg, është ndaluar vendosja e produkteve të listuara më poshtë që të vendosen në tregun e brendshëm. Në disa raste produktet nuk janë lejuar të futen në treg pasi që të njëjtat bartnin shenjën e konformitetit të Serbisë.

<i>Produkte që nuk janë lejuar të futen në treg</i>	
Shufra çeliku - armature	23980 kg
Bateri (akumulator) 135 AH	48 copë
Pajisje elektrike	1045 cope
Material elektrik	21 343 m
Tulla ndërtuese prej qeramike	1512 copë
Tekstil	4026 copë

*Koment: Këto të dhëna janë marrë nga raporti vjetor 2022 i Inspektoriatit Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut.*

*Gjetjet të cilat kërkojnë të trajtohen nga Inspektoriatit Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut referuar raportit vjetor në funksion të përputhshmërisë së produkteve.:*

- *Stafi i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha obligimeve të IQMT, problem ky i cili do të zgjidhet pas miratimit të rregullores për organizimin e brendshëm të IQMT;*
- *Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për fusha të caktuara të produkteve jo ushqimre;*
- *Mos definimi i kompetencave ndërmjet inspektorëve qendror të tregut dhe atyre në komuna;*
- *Mungesa e laboratorëve testues në vend për testimin e produkteve në funksion të përmbushjes së kërkesave të sigurisë si dhe procedura burokratike për kontraktim të këtyre laboratorëve.*

### **1.1. Arsyet për ndryshimet e nevojshme**

Ekzistojnë katër arsye pse Republika e Kosovës duhet ta ndryshojë kornizën e saj ligjore në fushën e mbikëqyrjes së përputhshmërisë lidhur me produktet:

- a) Zhvillimet në Bashkimin Evropian (BE) në vitin 2019 me miratimin e Rregullores (BE) 2019/1020 për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve dhe Rregullores (BE) 2019/515 për njohjen reciproke të mallrave të tregtuara ligjërisht në një tjetër Shtet Anëtar;



- b) Publikimi i Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet<sup>3</sup>, në janar 2022 i cili synon të përcaktojë parimet e inspektimit, rregullat e organizimit të organeve inspektuese (inspektorateve) në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunale si dhe përcaktimin e rregullave për koordinim dhe procedura e inspektimit;
- c) Vlerësimi se ligji nr. 06/L-41 për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit, i cili ndër të tjera ka transpozuar Rregulloren (EC) 765/2008 për mbikëqyrjen e tregut në lidhje me marketingun e produkteve, është shumë i ngushtë për t'u përdorur për transpozimin e Rregulloreve (BE) 2019/1020 dhe 2019/515;
- d) Nevoja për krijimin e njërive të reja organizative dhe përgatitjet për hyrje në sistemet horizontale të BE-së.

Si rezultat i ndryshimit të kësaj kornize ligjore dhe ndërmarrjes së veprimeve nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut do të sigurohet që produktet jo ushqimore në tregun e Republikës së Kosovës të jenë në përputhshmëri, çka nënkupton të mos rrezikojnë konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë të fundit. Ky ndryshim gjithashtu siguron mbrojtjen e interesave të tjerë publik si mjedisin, sigurinë dhe konkurueshmërinë në treg.

Në kuader të modernizimit të sistemit aktual të mbikëqyrjes së tregut, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut ndërmarrin më me lehtësi veprime të tilla si tërheqjen e produkteve, kthimin e produkteve dhe aplikimin e masave për të ndaluar qarkullimin e produkteve që nuk janë në përputhshmëri dhe/ose për t'i sjellë ato në përputhshmëri, mbikëqyrjen e shitjeve online për operatorët ekonomik të cilët do të regjistrohen në Republikën e Kosovës, shkëmbim të informatave për produktet e pa sigurta dhe të mos përputhshme.

Monitorimi dhe zbatimi i përputhshmërisë së produkteve me legjislacionin përkatës varet kryesisht nga kontrollet efikase dhe efektive të kryera nga autoritetet kombëtare të mbikëqyrjes së tregut.

Çelësi për transformimin dhe përmirësimin e funksionimit të tyre janë:

- Koordinim më i mirë ndërmjet autoriteteve të ndryshme,
- Komunikim i përmirësuar me bizneset që furnizojnë produkte dhe autoritetit përkatës të mbikëqyrjes së tregut,
- Përmirësim i gjurmimit dhe hetimit të produkteve që nuk janë në përputhshmëri të importuara nga jashtë,
- Caktimi i më shumë burimeve (fuqi punëtore, infrastrukturë, trajnime) të alokuara për mbikëqyrjen e tregut.

---

<sup>3</sup> **Ligji për Inspektimet** përmban një dispozitë (neni 2/2) që një ligj i veçantë i cili e rregullon një fushë të caktuar mund të ofrojë dispozita të veçanta për aspekte të ndryshme të procedurës së inspektimit. Siç u tha më herët, me qëllim që të ofrohet një lidhje me këtë ligj kornizë, rekomandohet që ligji parësor që do të hartohet në bazë të këtij Koncepti Dokumenti të titullohet si “**Ligji për Inspektimet e Përputhshmërisë së Produkteve**”.

Dispozitat të cilat i mungojnë legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen e tregut të produkteve sipas Rregullores (BE) 2019/1020, janë si në vijim:

- përshkrimi i rolit të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për të siguruar që vetëm produktet në përputhshmëri dhe të sigurta mund të bëhen të disponueshme në treg.

Qëllimet kryesore të mbikëqyrjes të tregut të produkteve të cilat janë identifikuar në mënyrë të qartë në nivel të Bashkimit Evropian:

- të mbrojë konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë të fundit,
- të sigurojë mbështetje për subjektet ekonomike dhe konkurrencën e drejtë,
- të bazojë aktivitetin e vazhdueshëm në konsultime konstruktive me të gjithë aktorët.

Mungesa e dispozitave për mbikëqyrjen e tregut e produkteve të cilat përfshijnë aktivitete dhe masat e marra nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut me qëllim që të sigurojnë që të vihen në dispozicion në treg vetëm produktet në përputhshmëri, të cilat ofrojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së interesit publik, dhe në veçanti mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në përgjithësi, mbrojtjen e konsumatorëve deri në atë masë dhe në mënyrën që mundëson qarkullimin e lirë të produkteve pa kufizime të panevojshme.

Përveç termeve të përdorura në Ligj (*prodhues, përfaqësues si autorizuar, importues, distributor*), vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet atyre që kanë të bëjnë me risitë (*definicione të reja*) për mënyrën e vendosjes së një produkti në treg:

- **ofruer i përmbushjes së shërbimit** nënkupton personin juridik ose fizik ose sipërmarrësin që ofron, gjatë veprimtarisë tregtare, të paktën dy nga shërbimet e mëposhtme: magazinimin, paketimin, adresimin dhe dërgimin, pa pasur pronësinë e produkteve të përfshira, duke përjashtuar shërbimet postare, shërbimet e dorëzimit të pakove dhe shërbimet e tjera postare ose shërbimet e transportit të kryera në përputhje me legjislacionin për shërbimet postare;
- **ofruer i shërbimit të shoqërisë së informacionit** nënkupton personin juridik ose fizik që ofron shërbime të shoqërisë së informacionit që normalisht sigurohen për shpërblim, në distancë, me mjete elektronike dhe me kërkesë individuale të një marrësi të atyre shërbimeve;
- **ndërfaqja në internet** nënkupton softuerin, duke përfshirë një ueb faqe, pjesë të një faqe në internet ose një aplikacion, që operohet nga ose në emër të një operatori ekonomik, dhe që shërben për t'i dhënë përdoruesve të fundit qasje në produktet e operatorit ekonomik;
- **Solvit** në Republikën e Kosovës nënkupton një organ ose një pjesë të një organi brenda administratës shtetërore në Republikës së Kosovës, e cila është pjesë e rrjetit të pikave SOLVIT në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian për zgjidhjen e shpejtë dhe joformale të problemeve me të cilat përballen personat fizik dhe juridik kur ushtrojnë të drejtat e tyre në tregun e brendshëm;

- **ICSMS** nënkupton një sistem evropian të informacionit dhe komunikimit elektronik për mbikëqyrjen e tregut, për komunikimin midis autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA).

Pengesë për mbikëqyrje efektive të tregut mbetet lista e plotë e autoriteteve që kryejnë mbikëqyrjen e tregut për fushat e produkteve jo ushqimore, përfshirë përshkrimet e kompetencave të tyre nga grupe individuale të produkteve, do të miratohet nga Qeveria me rregullore.

Mungesa e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në mes të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut do të organizohet nga "IQMT" përmes një njësie të veçantë organizative përgjegjëse për bashkëpunimin midis autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut (zyra ndërlidhëse).

Dispozitat në lidhje me detyrimet e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, roli i vlerësimit të rrezikut kur vendosin se cilat masa të zbatohen, roli dhe kompetencat e inspektorëve, veprimet korrigjuese të ndërmarra nga operatorët ekonomik, masat për produktet që paraqesin rrezik serioz, të drejtat e operatorëve ekonomik gjatë procedurës së mbikëqyrjes, aktivitetet e përbashkëta (autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, operatorët ekonomik dhe organizatat që përfaqësojnë përdoruesit e fundit) për të promovuar përputhshmërinë e produkteve, certifikatat e konformitetit të lëshuara nga një laborator testues i akredituar për qëllime të mbikëqyrjes së tregut duhet të transpozohen sakt dhe drejt në ligjin e ri duke respektuar kërkesat e Rregullores së BE-së 2019/1020..

Dispozitat mbi masat që mund të vendosen nga inspektori, nëse ai/ajo gjen mospërputhje të një produkti (p.sh. mospërputhje në formën e vendosjes apo mos vendosjes së shenjës së konformitetit dhe mungesa e dokumentacionit teknik apo dokumentacionit të pa kompletuar), dhe dispozitat për bashkëpunim midis inspektorëve dhe trupave të vlerësimit të konformitetit bazohen në vendimin nr. 768/2008/ EC.

Dispozitat kombëtare (të cilat në një mënyrë e cila është ligjërisht korrekte plotësojnë dispozitat transpozuar nga legjislacioni i BE-së ) kanë të bëjnë me kushtet për të besuar kontrole ose testimin e produkteve nga inspektorët e trupi për vlerësimin e konformitetit, mënyrën e marrjes së mostrave të produktit në rrjedhën e mbikëqyrjes së tregut dhe vendimit për kostot e procedurës së mbikëqyrjes.

Detyrimet e reja të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut përfshijnë ndër të tjera, mbikëqyrje efektive të produkteve brenda territorit të Republikës së Kosovës, pavarësisht nga mënyra e furnizimit të këtyre produkteve, marrja e masave të duhura, proporcionale dhe korrigjuese nga operatorët ekonomik, për të siguruar përputhshmërinë e produkteve me legjislacionin e veçantë dhe me këtë ligj, dhe marrjen e masave të përshtatshme kur operatori ekonomik nuk arrin të ndërmerë veprimet e nevojshme korrigjuese.

Një garë e barabartë për konkurrencë mes të gjitha subjekteve ekonomike dhe mbrojtja nga konkurrenca e padrejtë duhet të sigurohet në një treg të rregulluar. Për këtë qëllim, zbatimi i plotë i legjislacionit për produktet është gjithashtu i nevojshëm. Bashkëpunimi i mirë midis operatorëve ekonomik dhe autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut është thelbësor për ndërhyrjen e shpejtë dhe veprimet korrigjuese në lidhje me produktin. Është e domosdoshme që operatori ekonomik të jetë i

themeluar/regjistruar në Republikën e Kosovës, në mënyrë që autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të mund t'i adresojnë kërkesat, duke përfshirë kërkesat për informacion, në lidhje me përputhshmërinë e produktit me legjislacionin dhe i cili mund të bashkëpunojnë me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në mënyrë që të sigurohet se masat korrigjuese të menjëhershme janë marrë për të rregulluar rastet e mospërputhshmërisë, në lidhje me produktet.

Dispozitat mbi shitjet në distancë dhe mbi nevojën përkatëse për të identifikuar produktet e vëna në dispozicion në tregun e Republikën e Kosovës janë gjithashtu shumë të rëndësishme. Të gjitha produktet e ofruara për shitje në distancë në internet ose përmes mjeteve të tjera të shitjes në distancë konsiderohen të jenë të disponueshme në treg nëse oferta u drejtohet përdoruesve të fundit në Republikën e Kosovës. Një ofertë për shitje në distancë brenda kuptimit të këtij ligji konsiderohet se u drejtohet përdoruesve të fundit në Republikën e Kosovës nëse operatori ekonomik ofron mundësinë e dorëzimit, porositjes dhe pagesës ose ndryshe e drejton ofertën e tij në territorin e Republikës së Kosovës.

Në legjislacionin e ri do të përfshihen edhe dispozitat të cilat përfaqësojnë një kombinim të ndryshëm të burimeve ligjore, e të cilat aktualisht mungojnë:

- Pika e Kontaktit të Produktit - Rregullorja për (BE) 2019/515 dhe Rregullorja (BE) 2019/1020,
- ICSMS (Sistemi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit) - Rregullorja (BE) 2019/1020
- RAPEX (Shkëmbimi i informacionit mbi produktet e rrezikshme) - Rregullorja (EU) 2019/1020 dhe Direktiva 2001/95/EC .

Republika e Kosovës tashmë ka sistemin e saj "kombëtar" për mbikëqyrjen e tregut të produkteve dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me përputhshmërinë dhe/ose sigurinë e tyre. Ky ligj kërkon që "Inspektorati " të mirëmbajë sistemin ekzistues të informacionit në një mënyrë të tillë që, përmes një ndërfaqe elektronike, të mund të bëhet pjesë e ICSMS pasi të plotësohen kushtet për të hyrë në atë sistem.

Mënyra më efektive për të siguruar që produktet e rrezikshme dhe ato të cilat nuk janë në përputhshmërisë për të mos vendosur në treg do të jetë kryerja e kontrolleve adekuate para se të "lirohen për qarkullim të lirë " *(një procedurë e përcaktuar në ligj që rregullon kontrollin doganor)*

## **1.2 Niveli aktual i harmonizimit të legjislacionit vendor me Bashkimin Evropian**

Republika e Kosovës deri në vitin 2018 ka përafuar legjislacionin e saj me rregullat e atëhershme të BE-së të cilat kërkonin nga shtetet anëtare që, sipas rregullave për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut, ta organizojnë dhe të bëjnë monitorimin e produkteve të vëna në dispozicion në treg. Pas shpalljes së Pavarësisë, Republika e Kosovës miratoi dy ligje primare jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të ndërlidhura në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave/sigurinë e produkteve:

- Ligji nr. 04/L-039 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (i miratuar më 2011), i cili përfaqëson transpozimin e pjesës së Rregullores (KE) 765/2008, dhe
- Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-189 (i miratuar në vitin 2012, përkatësisht 2013). Aktualisht Ligji i ri për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve i cili është transpozim i plotë i Direktivës 2001/95/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 3 dhjetorit 2001 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Direktivës 357/87/EC të 25 qershorit 1987 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për imitimimin e produkteve ushqimore, pritet të miratohet në lexim të dytë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë marsit 2023.

Të dy ligjet u miratuan pothuajse paralelisht me synimin për ta formuar një sistem ligjor koherent. Ndërsa ligji i parë kishte si qëllim kryesor krijimin e një baze të përshtatshme ligjore për rregullimin e një game të gjerë të produkteve industriale (jo-ushqimore) p.sh. makineritë, pajisjet elektrike, ashensorët, lodrat, pajisjet mbrojtëse personale (kërkesat e tyre dhe vlerësimi i konformitetit në lidhje me to), në nivelin sekondar përmes rregulloreve teknike, kjo e fundit siguroi kornizën ligjore direkte rregullatore për produktet ose aspektet e produkteve të cilat nuk ishin të rregulluara nga rregulloret tjera teknike.

Në vitin 2018 filloi një reformë e re ligjore në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave/sigurisë së produkteve. Ligji për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësim të Konformitetit i vitit 2011 u zëvendësua nga ligji Nr. 06/L-041. Ligji i ri ka prezantuar shumë dispozita të reja në lidhje me trupat e vlerësimit të konformitetit dhe posaçërisht në lidhje me fuqinë dhe kompetencat e autoriteteve të inspektimit. Përmes “Rregullores (QRK) Nr. 24/2020 për Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese”. Ligji ekzistues për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit i vitit 2018 bazohet kryesisht në transpozimin e parimeve dhe rregullave të Rregullores (KE) 765/2008 (pjesa e Mbikëqyrjes së Tregut).

Pasi Rregullorja 765/2008/EC u zëvendësua me Rregulloren 2019/1020/EU, për t'u përafuar plotësisht me rregullat përkatëse të BE-së, rregullatori i Kosovës duhet të shqyrtojë mundësinë e miratimit të një “Ligji të veçantë për Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve” (që adreson punën e të gjitha autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, jo vetëm të Inspektoratit të Tregut) për të transpozuar dispozitat e Rregullores 2019/1020/EU që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut. Në Shtojcën I të Rregullores 2019/1020/EU është e definuar “Lista e legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian” e cila numëron 70 akte ligjore të BE-së për produktet jo ushqimore të cilat janë objekt i Rregullores së miratuar për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve.

Në këtë rast, “Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit” duhet të përdoret vetëm për transpozimin e Vendimit 768/2008/EC që është një zgjidhje e përhapur në shtetet e tjera”.

Duhej të merreshin masat e duhura për të siguruar që dispozitat e Rregullores (KE) 765/2008 (para se të zëvendësohej në vitin 2019), të Direktivës 2001/95/KE për sigurinë e përgjithshme të produktit dhe të legjislacionit tjetër të harmonizimit të Bashkimit Evropian, **si dhe legjislacioni kombëtar i**

**pa harmonizuar** në fuqi, në veçanti, për të parandaluar vënien në dispozicion në treg dhe përdorimin e produkteve që nuk përputhen dhe/ose janë të pasigurta.

Sa i përket përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ky ligj do të transpozohet dispozitat:

**a) Përputhshmëria e draftit/ legjislacionit të propozuar me legjislacionin primar të Bashkimit Evropian:**

**Traktati mbi Funksionimin e BE-së, Pjesa I, Tregu i Brendshëm, Neni 26**

**b) Përputhshmëria e draftit / legjislacionit të propozuar me legjislacionin sekondar të Bashkimit Evropian**

*E harmonizuar plotësisht:*

Rregullorja (BE) 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Qershorit 2019 mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve dhe ndryshimin e Direktivës 2004/42 /EC dhe Rregulloret (EC) Nr. 765/2008 dhe (BE) Nr 305/2011.

Vetëm dispozitat e nevojshme për të krijuar një bazë ligjore për ndryshimet institucionale që duhet të zbatohen para anëtarësimit dhe për ushtrimin e kompetencave që janë tashmë të nevojshme për të kryer mbikëqyrjen e tregut në mënyrë adekuate do të transpozohen përmes Ligjit.

Dispozitat e Rregullores (BE) 2019/1020 të cilat do të zbatohen drejtpërdrejt pas hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian nuk do të transpozohen.

*E harmonizuar pjesërisht:*

Rregullorja (BE) 2019/515 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 Marsit 2019 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar dhe shfuqizimi i rregullores (KE) 764/2008.

Vetëm neni 9 “Detyrimet e pikave të kontaktit të produkteve” do të transpozohet në ligj pasi neni 8 “Informacioni për operatorët ekonomik” i Rregullores (BE) 2019/1020 i referohet zbatimit të këtij neni.

Pjesërisht të harmonizuara:

- Vendimi Nr. 768/2008 / EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 9 korrikut 2008 mbi një kornizë të përbashkët për tregtimin e produkteve dhe shfuqizimin e Vendimit të Këshillit 93/465 / EEC , OJ L 218, 13.08.2008.

Vendimi Nr. 768/2008 / EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 9 korrikut 2008 mbi një kornizë të përbashkët për tregtimin e produkteve, i cili është një akt ligjor “sui generis” që detyron politikisht organet e BE-së të përdorin kryesisht zgjidhjet e "Kornizës së re ligjore" në legjislacionin e ardhshëm, nuk ka nevojë të transpozohet dhe zbatohet në nivelin e Shtetit Anëtar përmes rregullave të BE-së për harmonizim. Republika e Kosovës është duke e harmonizuar legjislacionin e saj me

këtë vendim përmes transpozimit të rregullave të BE-së për harmonizim në formën e direktivave/rregulloreve lidhur me produktet.

*E harmonizuar pjesërisht:*

c) Përputhshmëria e draftit / legjislacionit të propozuar me aktet e tjera ligjore të Bashkimit Evropian

- Rekomandimi i Komisionit 2013/461 / BE i 17 Shtatorit 2013 mbi parimet që rregullojnë SOLVIT;

Ligji nuk e themelon **Qendrën SOLVIT** të Republikës së Kosovës, por themelimin eventual të Qendrës SOLVIT (që mbulon fushë më të gjerë sesa ky ligj) është një parakusht për zbatimin e plotë të ligjit/Rregullores 2019/515 pas anëtarësimit në BE.

- Rregullorja (BE) 2018/1724 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 2 Tetorit 2018 që krijon një portë të vetme digjitale për të siguruar qasje në informacion, procedurat dhe asistencën dhe shërbimeve të zgjidhjes së problemeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1024/2012.

Ligji nuk krijon një **“portë të vetme digjitale”** në Republikën e Kosovës por krijimi i saj (që mbulon një fushë shumë më të gjerë se ky Ligj) është një parakusht për zbatimin e plotë të Ligjit si dhe të Rregullores 2019/1020 dhe 2019/515 pas anëtarësimit në BE.

Ligji Nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-189 (2013), transpozoi direktivën për sigurinë e përgjithshme të produkteve. Ndërsa Ligji nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit u miratua në maj 2018. Ndër të tjera ka ruajtur dhe zgjeruar transpozimin e Rregullores (EC) 765/2008 dhe është konsideruar se është plotësisht në përputhje me atë akt ligjor.

Mbi këtë bazë ligjore, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në Kosovë sigurojnë që produktet jo ushqimore në tregun e Republikës së Kosovës janë në përputhshmëri, çka nënkupton të mos rrezikojnë konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë të fundit. Gjithashtu sigurojnë mbrojtjen e interesave të tjera publike si mjedisin, sigurinë në punë dhe konkurrencën në tregti. Mbikëqyrja e tregut përfshinë edhe veprime të tilla si tërheqjen e produkteve, kthimin e produkteve dhe aplikimin e masave për të ndaluar qarkullimin e produkteve që nuk janë në përputhshmëri dhe/ose për t'i sjellë ato në përputhshmëri.

Monitorimi dhe zbatimi i përputhshmërisë së produkteve me legjislacionin përkatës varet kryesisht nga kontrollet efikase dhe efektive të kryera nga autoritetet kombëtare të mbikëqyrjes së tregut.

Në dekadën e fundit, u konstatua në nivel global se çelësi për përmirësimin e funksionimit të tyre është:

- Koordinim më i mirë ndërmjet autoriteteve të ndryshme,
- Komunikim i përmirësuar me bizneset që furnizojnë produkte dhe autoritetit përkatës të mbikëqyrjes së tregut,

- Përmirësim i gjurmimit dhe hetimit të produkteve që nuk janë në përputhshmëri të importuara nga jashtë,
- Caktimi i më shumë burimeve (fuqi punëtore, infrastrukturë, trajnime) të alokuara për mbikëqyrjen e tregut.

Këto janë arsytet përse BE-ja në vitin 2019 miratoi një Rregullore të re (BE) 2019/1020 për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve. Ajo u miratua me qëllimin që të përmirësohet dhe të modernizohet mbikëqyrja ekzistuese e tregut. Me të u zëvendësuan dispozitat e mbikëqyrjes së tregut të Rregullores (KE) 765/2008 nga data 16 korrik 2021 dhe u përmirësuan në veçanti dispozitat për mbikëqyrjen e tregut, detyrimet e bizneseve, mekanizmat e gjurmimit dhe të mbrojtjes.

Rregullorja (BE) 2019/1020 vlen për 70 rregullore dhe direktiva që harmonizojnë kërkesat në nivel të BE-së për produktet joushqimore për t'i mbrojtur konsumatorët, shëndetin dhe sigurinë, mjedisin dhe interesat e tjera publike (të gjitha aktet ligjore janë identifikuar në Shtojcën I të Rregullores).

Rregullorja i përmirëson dispozitat e mëparshme, në veçanti:

- Duke parandaluar mos përputhshmërinë përmes ofrimit të informatave për bizneset dhe aktivitetet të përbashkëta me to,
- duke ofruar mjete më efektive të zbatimit për adresimin e shitjeve përmes internetit,
- përmes bashkëpunimit të përmirësuar: mes shteteve të BE-së, mes autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe doganave dhe përmes një rrjeti të përputhshmërisë së produkteve në BE<sup>4</sup>.

Korniza për mbikëqyrjen e tregut, e vendosur me Rregullore, i plotëson dhe forcon dispozitat ekzistuese në legjislacionin harmonizues të Bashkimit në lidhje me sigurimin e përputhshmërisë së produkteve dhe kornizën për bashkëpunimin me organizatat që përfaqësojnë operatorët ekonomik ose përdoruesit e fundit, mbikëqyrjen e tregut të produkteve dhe kontrollin mbi ato produkte që hyjnë në tregun e Unionit.

Megjithatë, në përputhje me parimin *lex specialis*, Rregullorja zbatohet vetëm përderisa nuk ka dispozita specifike me të njëjtin objekt, natyrë ose efekt në legjislacionin harmonizues të Bashkimit. Dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje, nuk duhet të zbatohen në fushat e mbuluara nga dispozita të veçanta, për shembull ato të përcaktuara për<sup>5</sup>:

- produktet kozmetike,
- pajisjet mjekësore.

<sup>4</sup> Bosnia dhe Hercegovina aplikoi në vitin 2021 për të qenë vëzhguese në takimet e Rrjetit. Asaj iu dha statusi i vëzhguesit.

<sup>5</sup> **VËREJTJE:** Grupet e produkteve të dhëna si shembull janë të gjitha në Shtojcën 1 të Rregullores. Ato janë në fushëveprimin e Rregullores, kështu që dispozitat e saj duhet të zbatohen kur kemi të bëjmë me produkte kozmetike, pajisje mjekësore dhe automjete. Përjashtimi (i pjesshëm) bëhet nëse ka: “dispozita specifike me të njëjtin objekt, natyrë ose efekt në legjislacionin harmonizues të Bashkimit”. Nëse “dispozitat specifike” nuk përfshijnë gjithçka që përfshin kjo rregullore, ato duhet të kombinohen me dispozitat e kësaj rregulloreje (p.sh. detyrimi për të hartuar një Strategji të mbikëqyrjes së tregut).



- Automjetet (mjetet motorike).

Disa përkufizime që janë dhënë në Rregulloren (KE) Nr. 765/2008 janë harmonizuar me përkufizimet e dhëna në akte të tjera ligjore të Bashkimit dhe, sipas nevojës, reflektojnë arkitekturën e zingjireve moderne të furnizimit.

Rregullorja e re ka ndikimin më të madh në shitjet përmes internetit të cilat e kalojnë kufirin e BE-së. Deri në miratimin e Rregullores, shitjet “B2C” ku biznesi ndodhet jashtë BE-së dhe klienti është në BE nuk ishin të rregulluara. Kjo për shkak se nuk kishte asnjë person juridik zyrtarisht përgjegjës për pajtueshmërinë rregullatore të produkteve të blera jashtë BE-së. Klientët shiheshin si "importues" dhe duhej të siguroheshin që të blinin vetëm produkte të përputhshme në internet. Por në praktikë, konsumatorët rrallë e dinë se çfarë është në të vërtetë pajtueshmëria rregullatore dhe si mund të verifikohet.

Megjithatë, nga 16 korriku 2021, shitësit jashtë BE-së duhet të kenë një përfaqësues të autorizuar në BE për t'iu shitur produkte konsumatorëve në BE. Rregullorja për Mbikëqyrjen e Tregut përcakton rregullat sipas të cilave ofruesi i përmbushjes së shërbimit do të mbahet përgjegjës kur shitësi jashtë BE-së nuk cakton një person përgjegjës. Kështu, kompanitë si Amazon do të duhet të sigurojnë që të gjithë shitësit e tyre jashtë BE-së e kanë një përfaqësues të autorizuar të emëruar brenda BE-së për ta shmangur përgjegjësinë (ose do t'iu ndalohet të vendosin produkte në treg).

Rregullorja ofron një përmbajtje të re në krahasim me të kaluarën. Përmbajtja që përfshinë nenet e cekura më poshtë (dhe të cilat do të duhet të transpozohen nëse qëllimi është harmonizimi) nuk kanë qenë pjesë e Rregullores 765:

- Detyrat e operatorëve ekonomik ... (neni 4),
- Përfaqësuesi i autorizuar (neni 5),
- Shitjet në distancë (neni 6),
- Informatat për operatorët ekonomikë (neni 8),
- Aktivitetet e përbashkëta për promovimin e pajtueshmërisë (neni 9),
- Themelimi i zyrës së vetme ndërlidhëse ... (neni 10),
- Aktivitetet e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut (neni 11),
- Strategjia kombëtare për mbikëqyrjen e tregut (neni 13),
- Rikthimi i kostove nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut (neni 15),
- Aktivitetet testuese të Bashkimit (neni 21) dhe
- Sistemi i informimit dhe komunikimit (neni 34).

### **1.3 Publikimi i Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet**

Në vitin 2018 filloi një reformë e re ligjore në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave/sigurisë së produkteve. Ligji për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësim të Konformitetit i vitit 2011 u zëvendësua nga ligji Nr. 06/L-041. Ligji i ri ka prezantuar shumë dispozita të reja në lidhje me trupat e vlerësimit të konformitetit dhe posaçërisht në lidhje me fuqinë dhe kompetencat e autoriteteve të inspektimit. Përmes Rregullores (QRK) Nr. 24/2020 për Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i

mbikëqyrjes inspektuese, kompetencat për grupet e ndryshme të produkteve janë ndarë mes inspektorateve të ndryshme.

**Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet<sup>6</sup> që u publikua** në janar 2022 i përcakton parimet e inspektimit, rregullat për organizimin e organeve të inspektimit në kompetencën e administratës shtetërore dhe komunale, rregullat për koordinim dhe aktivitetin e inspektimit dhe procedurën e inspektimit.

Në nenin 2, ofron një zgjidhje që një ligj i veçantë që i rregullon inspektimet në një fushë të caktuar mund të ofrojë dispozita të caktuara për aspekte të ndryshme të procedurës së inspektimit. Nëse një çështje që ka të bëjë me inspektimet nuk është e rregulluar me një ligj të veçantë, vlejné dispozitat e Ligjit.

Njëra prej dispozitave më të rëndësishme është neni 12 që i përcakton përgjegjësitë e Zyrës së Inspektorit:

- 1.1. udhëheq programin e reformës në inspektim në Republikën e Kosovës,
- 1.2. mbështet ministritë, komunat, agjencitë ekzekutive ose rregullatore në mbikëqyrjen e performancës së organeve të inspektimit nën fushëveprimin e saj,
- 1.3. koordinon dhe mbështet aktivitetet e organeve inspektuese me qëllimin e vetëm të zvogëlimit të barrës administrative të subjekteve inspektuese, duke përfshirë koordinimin e inspektimeve të përbashkëta në terren nga organet inspektuese kur qeveria miraton inspektime tematike.
- 1.4. ofron opinione për planet vjetore të organeve inspektuese të miratuara nga ministrë ose komunat përkatëse.
- 1.5. harton dhe miraton udhëzimet e përgjithshme dhe metodologjitë për vlerësimin e rrezikut, planifikimin dhe koordinimin e inspektimit, evidentimin e aktiviteteve të inspektimit dhe raportimin.
- 1.6. miraton udhëzimet e përgjithshme për treguesit e performancës për aktivitetet e inspektimit që e vlerësojnë efektivitetin e tyre,
- 1.7. përgatit raportin vjetor për inspektimet e kryera nga të gjitha organet inspektuese dhe e dorëzon atë për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës,
- 1.8. lëshon opinione për nisma ligjore dhe nën-ligjore në fushën e inspektimeve, të ndërmarra nga qeveria në bazë të parimeve dhe rregullave të ofruara nga ky ligj.
- 1.9. krijon dhe mirëmban platformën elektronike të inspektimeve, që përdoret për organizimin dhe koordinimin e inspektimeve, këmbimin e informatave mes organeve inspektuese dhe informatave publike,
- 1.10. mban një listë të përditësuar të të gjithë inspektorëve në detyrë në çdo organ inspektues dhe e publikon në portalin qendror të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi,
- 1.11. e mban një regjistër të përditësuar të të gjitha organeve inspektuese në Kosovë dhe funksionet e tyre inspektuese sipas këtij ligji dhe ligjeve të caktuara.

---

<sup>6</sup> Ligji është miratuar nga Kuvendi dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më 18 janar 2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Është qenësore që hartuesit e Ligjit të ri për Inspektimin e përputhshmërisë së produkteve t'iu përmbahen dispozitave të Ligjit të ri për Inspektimet dhe të përpiqen të sigurojnë që nuk do të shkaktohen efekte të dëmshme ndaj sistemit koherent të mbikëqyrjes së tregut për përputhshmërinë dhe sigurinë e produkteve jo-ushqimore.

Në kuadër të reformës së inspektimeve e cila derivon nga Ligji për Inspektime, do të ristrukturohet Trupi Koordinues ekzistues për Mbikëqyrjen e Tregut dhe ky trup do të qëndrojë në legjislacionin e ardhshëm për përputhshmërinë e produkteve dhe do të udhëhiqet nga Inspektori i Përgjithshëm (IP). Gjithashtu edhe “Zyra e vetme ndërlidhëse” e cila do të themelohet sipas ligjit të ri do të vendoset në kuadër të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm.

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm është poashtu përgjegjëse për krijimin e Sistemit Elektronik të Inspektimit (në zhvillim me disa vonesa) i cili do e lehtësojë mbikëqyrjen inspektuese dhe aktivitetet e inspektorëve. Në të njëjtën kohë do mundësoj klasifikim dhe gjenerim të të dhënave në kohë reale. Platforma ekzistuese RAPEX-Kosova (*Shkëmbimi i shpejtë i informatave për produktet e rrezikshme*) i cili menaxhohet nga Inspektorati i Tregut, në të ardhmen do të freskohet dhe azhurnohet me të dhëna të reja të cilat do të integrohen brenda kësaj platforme. E njëjta vlen edhe për ICSMS (Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit të Mbikëqyrjes së Tregut) i cili kërkohet nga Rregullorja (BE) 2019/1020 që të përdoret për të ruajtur të dhëna mbi aktivitetet e inspektimit në lidhje me përputhshmërinë e produkteve.

#### **1.4 Ligji për Kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit shumë i ngushtë për t'u përdorur për transpozimin e Rregulloreve (BE) 2019/1020 dhe 2019/515**

BE-ja ka rregulluar një kornizë të gjerë horizontale për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së tregut me një bazë ligjore prej 70 aktesh që përfshijnë grupe të caktuara produktesh, siç mund të shihet në Shtojcën 1 të Rregullores (BE) 2019/1020.

Nëse e krahasojmë këtë fushëveprim me fushëveprimin e legjislacionit të produkteve të Kosovës, shohim listën e mëposhtme të fushave të përfshira. Ai përfshin të paktën ligjet e mëposhtme parësore të Kosovës:

- Ligji nr. 06/L-041 për Kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit,
- Ligji nr. 04-L-197 për Kemikatet,
- Ligji nr. 06/L-037 për Metrologjinë,
- Ligji nr. 04-L-109 për Komunikimet elektronike,
- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e mjedisit,
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat,
- Ligji nr. 05/L-132 për Automjetet,
- Ligji nr. 04/L-179 për Transportin rrugor,
- Ligji nr. 06/L-033 për Produktet e ndërtimit,
- Ligji nr. 06/L-031 për Pajisjet e presionit,
- Ligji nr. 06/L-079 për Eficiencën energjetike,
- Ligji nr. 04/L-190 për Produktet medicinale dhe pajisjet mjekësore,

- Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga zjarri,
- Ligji nr. 04/L-022 për Përdorimin civil të eksplozivëve.

Është e qartë se Rregullorja (BE) 2019/1020 është shumë e gjerë për t'u transpozuar si kapitull i një ligji parësor që merret vetëm me disa grupe të produkteve që i përfshinë Rregullorja. Ekziston një nevojë thelbësore për një ligj parësor të kornizës së pavarur të përgjithshme për rregullat e mbikëqyrjes së tregut, e cila do t'i përfshinte në të njëjtën mënyrë të gjitha produktet të mbuluara nga një numër i madh ligjesh materiale të përshkruara më sipër.

### 1.5 Nevoja për themelimin e njësive të reja organizative dhe përgatitjet të hyrë në sistemet horizontale të BE-së

a) Republika e Kosovës, si çdo Shtet Anëtar, e cakton një **zyre të vetme ndërlidhëse**. Zyra e vetme ndërlidhëse do të jetë së paku përgjegjëse për përfaqësimin e pozitës së koordinuar të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe autoriteteve doganore dhe për komunikimin e strategjive kombëtare sipas Rregullores. Zyra e vetme ndërlidhëse poashtu ndihmon në bashkëpunimin mes autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut në Shtete të ndryshme anëtare. Pikat kufitare janë vendi më i përshtatshëm për zbulimin e produkteve të rrezikshme dhe / ose të cilat nuk janë në përputhshmëri (duke përfshirë produktet në të cilat marka CE është vendosur gabimisht ose në mënyrë mashtruese) para se të vendosen produktet në treg.

b) Ekzistojnë parakushte të tjera për zbatimin e kërkesave të Rregullores 1020 dhe 515 kur Kosova të hyjë në BE. Administratat kombëtare duhet të themelojnë institucione dhe procedura sipas:

- Rregullores (BE) 2018/1724 për themelimin e një **portali të vetëm digjital** për të ofruar qasje në informata, procedura, asistencë dhe shërbime të zgjidhjes së problemeve,
- Rekomandimeve të Komisionit 2013/461/BE për parimet që e rregullojnë **SOLVIT**.

c) Është e rëndësishme për tregun e brendshëm të mallrave që bizneset, veçanërisht NVM-të, të mund të marrin informata të besueshme dhe specifike rreth ligjit në fuqi në një Shtet Anëtar të caktuar. **Pikat Kontaktuese të Produkteve** duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e komunikimit mes autoriteteve kombëtare dhe operatorëve ekonomik duke shpërndarë informata rreth rregullave specifike të produkteve dhe mënyrës se si zbatohet parimi i njohjes së ndërsjellë në territorin e shtetit të tyre. Prandaj, është e rëndësishme të rritet roli i Pikave Kontaktuese të Produkteve si ofrues parësorë të informatave për të gjitha rregullat lidhur me produktet, duke përfshirë rregullat teknike kombëtare të përfshira me njohje të ndërsjellë.

### *Tabela 3: Pema e problemit që e paraqet problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij*

<b>Problemi kryesor</b>	Mungesa e harmonizimit të legjislacionit të ri të BE-së për mbikëqyrjen e tregut, pas reformës në vitin 2019 dhe mungesa e koherencës së sistemit kombëtar të mbikëqyrjes së inspektimit pas miratimit të Ligjit nr. 08/L-067 për Inspektimet që ndërlidhë domosdoshmërinë e rregullimit të kornizës ligjore në fushën e mbikëqyrjes së përputhshmërisë për produktet, e cila është e mbuluar vetëm pjesërisht me Ligjin për Kerkesat teknike për Produkte dhe Vlerësim të konformitetit
<b>Shkaqet</b>	Dispozitat e Ligjit në fuqi për kerkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (pjesa e mbikëqyrjes së tregut) janë të pa mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e reja për operatorët ekonomik, shitjet në distancë, aktivitetet e përbashkëta për promovimin e përputhshmërisë së produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut, mungesa e koordinimit e cila do të realizohet përmes zyrës së vetme ndërlidhëse, mungesa e strategjisë kombëtare të mbikëqyrjes së tregut po pamundëson zbatimin e legjislacionit kornizë në fushën e përputhshmërisë së produkteve jo ushqimore.
<b>Efektet</b>	<p>Mungesa e reformës në legjislacionin për mbikëqyrjen e tregut të produkteve dhe ndërlidhja e tij me aktet tjera ligjore (<i>rregullat teknike për produkte</i>) ka penguar inspektimin efektiv të përputhshmërisë së produkteve në treg.</p> <p>Pambulueshmëria e operatorëve ekonomik të përfshirë në tregtinë elektronike.</p> <p>Përshkrimi i pasaktë i kompetencave të autoriteteve inspektuese duke përfshirë edhe grupet e produkteve të cilat ata mbulojnë, ka shkaktuar shmangie nga mbikëqyrja, produkte të pa përputhshme me kerkesat themelore dhe kerkesat e standardeve të cilat mbulojnë produktet përkatëse.</p> <p>Mbulimi jo i plotë i legjislacionit në fushën e pa harmonizuar ka rezultuar në produkte të pa përputhshme dhe kufizime në tregtim.</p> <p>Mungesa e njësive të nevojshme organizative për zbatimin e rregullave të harmonizuara me legjislacionin e BE-së.</p>

**Tabela 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit**

<b>Emri i palëve me interes</b>	<b>Shkaku (et) me të cilat</b>	<b>Efekti (et) me të cilat lidhen palët me interes</b>	<b>Mënyra në të cilën palët</b>
---------------------------------	--------------------------------	--	---------------------------------

	<b>lidhen palët e interesit</b>		<b>e interesuara lidhen me këto shkaqe ose pasoja</b>
ZKM/Inspektori i Pergjithshëm/	Përshkrimi i pasaktë i kompetencave të autoriteteve inspektuese duke përfshirë edhe grupet e produkteve	Mbikëqyrje jo efektive e tregut	Direkt
Inspektorati Qendror për mbikëqyrjen e tregut/MINT	Mungesa e reformës në legjislacionin për mbikëqyrjen e tregut të produkteve dhe ndërlidhja e tij me aktet tjera ligjore ( <i>rregullat teknike per produkte</i> )	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt
Dogana e Kosovës/MF	Afat i shkurtë për trajtimin e produkteve (vetëm 3 ditë)	Pamundesi për eliminimin e mangësive formale nga Operatoret ekonomik për shkak të afatit të shkurtë	Direkt
MMPHI	Mangësi e harmonizimit të dispozitave ligjore	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt dhe indirekt
MSH	Mangësi e harmonizimit të dispozitave ligjore	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt dhe indirekt
ME	Mangësi e harmonizimit të dispozitave ligjore	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt dhe indirekt
MPPB	Mangësi e harmonizimit të dispozitave ligjore	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt dhe indirekt
ARKEP	Mangësi e harmonizimit të dispozitave ligjore	Mbikëqyrje jo efektive e tregut dhe produkte të pa përputhshme në treg	Direkt dhe indirekt

## Kapitulli 2: Objektivat

*Tabela 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

Objektivi i përgjithshëm	Emri i dokumentit relevant planifikues
<p>Përmirësimi i funksionimit të sistemit të mbikëqyrjes së tregut me qëllim të zvogëlimit të numrit e produkteve që nuk përputhen në tregun e vendor.</p>	<p>Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit</p> <p>Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit (2022-2026)</p>
<p><b>Objektivi strategjik</b> – Përafrimi i metejmë i kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit.</p>	<p><b>Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit (2022-2026), Blloku 3:</b> Kapitulli 1: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-in e BE-së, <b>Masat afatmesme transpozimi i Rregullores 2019/1020 dhe Rregullores 2019/515.</b></p>
<p><b>Objektivat specifike:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dispozitat për inspektimin e përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve të harmonizuara me acquis të BE të cilat zbatohen për të gjitha produktet jo ushqimore;</li> <li>2. Ndërtimi i një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm për autoritetet e mbikëqyrjes së tregut;</li> <li>3. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik dhe autoriteteteve të mbikëqyrjes së tregut në ngritjen e nivelit të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve në treg;</li> <li>4. Rritja e vetëdijes së bizneseve dhe konsumatorëve/përdoruesve të fundit në lidhje me përputhshmërinë dhe sigurinë e produkteve;</li> <li>5. Inkurajimi i përdorimit të standardeve teknike për ta arritur një nivel të lartë të sigurisë dhe përputhshmërisë së produkteve.</li> </ol>	<p>Objektivat specifike janë rezultat i analizës së bërë për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti.</p>

## Kapitulli 3: Opsionet

Për të shtjelluar problemin kryesor të identifikuar dhe analizuar në këtë koncept dokument, më poshtë janë paraqitur tri opsione të mundshme:

1. “Pa ndryshim”, sipas të cilit situata aktuale dhe rrjedhimisht vështirësitë e paraqitura do të vazhdonin në praktikë (**Opsioni 1**).
2. Miratimi i Ligjit të ndryshuar për Kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësim të konformitetit dhe përmirësimi i zbatimit të tij (**Opsioni 2**).
3. Miratimi i Ligjit të ri për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve (**Opsioni 3**).

### 3.1: Opcioni 1-"Pa ndryshime"

Mbajtja e tekstit të Ligjit në fuqi nr. 06/L-41 për Kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit (kapitulli për *Inspektimin e Tregut*) do të nënkuptonte se Republika e Kosovës ka vendosur të mos i përcjellë ndryshimet e paraqitura në nivel të BE-së për të forcuar punën e inspektorateve të cilat kanë detyrën e zbatimit të rregulloreve teknike që mbulojnë sigurinë dhe kërkesat e tjera të produkteve që vendosen në treg.

**Rregullorja (BE) 2019/1020** për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve u publikua pas miratimit të Ligjit nr. 06/L-041, me qëllim të përmirësimit dhe modernizimit të mbikëqyrjes ekzistuese të tregut. Ajo i zëvendësoi dispozitat e mbikëqyrjes së tregut të Rregullores (KE) 765/2008 dhe i përmirësoi ato në veçanti me dispozitat për organizimin e mbikëqyrjes së tregut, detyrat e operatorëve ekonomik, gjurmimin e produkteve dhe përdorimin e bazave elektronike të të dhënave në punën e autoriteteve inspektuese.

Rregullorja (BE) 2019/1020 vlen për 70 rregullore dhe direktiva që i harmonizojnë në nivel të BE-së kërkesat për produktet jo-ushqimore për mbrojtjen e konsumatorëve, shëndetin dhe sigurinë, mjedisin dhe interesat e tjerë publik (të gjitha aktet ligjore të identifikuara në Shtojcën I të Rregullores – e kopjuar në Shtojcën 2 të këtij dokumenti). Rregullorja i përmirëson dispozitat e kaluara në veçanti:

- duke parandaluar mos përputhshmërinë përmes ofrimit të informatave për bizneset dhe aktivitetet të përbashkëta me to,
- duke ofruar mjete më efektive të zbatimit për adresimin e shitjeve përmes internetit,
- përmes bashkëpunimit të përmirësuar: mes shteteve të BE-së, mes autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe doganave dhe përmes një rrjeti të përputhshmërisë së produkteve në BE.

**Rregullorja (BE) 2019/515** u miratua pasi që rregullat për fushën e paharmonizuar kishin disa mangësi, prandaj duhej të rishikoheshin dhe të përforcoheshin. Rregullorja ka për qëllim të



themelojë procedura të qarta për të siguruar lëvizjen e lirë të mallrave që tregtohen ligjërisht në një Shtet tjetër Anëtar dhe për të siguruar që lëvizja e lirë mund të kufizohet vetëm kur Shtetet Anëtare kanë baza legjitime të interesit publike për ta bërë këtë dhe që kufizimi është i arsyeshëm dhe proporcional.

Është e rëndësishme për tregun e brendshëm të mallrave që bizneset, në veçanti NVM-të, të mund të marrin informata të besueshme dhe specifike rreth ligjit në fuqi në një shtet të caktuar. **Pikat Kontaktuese të Produkteve** duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e komunikimit mes autoriteteve kombëtare dhe operatorëve ekonomik duke shpërndarë informata rreth rregullave specifike të produkteve dhe mënyrës se si zbatohet parimi i njohjes së ndërsjellë në territorin e shtetit të tyre.

Ekzistojnë parakushte të tjera për zbatimin e të gjitha kërkesave të Rregullores 1020 dhe 515 kur Republika e Kosovës të hyjë në BE. Administratat kombëtare duhet të themelojnë institucione dhe procedura sipas:

- Rregullores (BE) 2018/1724 për themelimin e një portali të vetëm digjital për të ofruar qasje në informata, procedura, asistencë dhe shërbime të zgjidhjes së problemeve,
- Rekomandimeve të Komisionit 2013/461/BE për parimet që e rregullojnë.

Nga pikëpamja e koherencës së rregullit kombëtar ligjor, Ligji i pandryshuar nr. 06/L-41 nuk do ta plotësonte dhe nuk do të ishte krejtësisht koherent me Ligjin nr. 06/L-067 për Inspektimet. Veçanërisht, dispozitat për nevojën për koordinimin e punës së inspektorateve kompetente (dhe cili institucion e ka për detyrë koordinimin) do të shkaktonin nevojën për qartësim.

Zgjedhja e Opsionit 1, “Pa ndryshim” do të ngadalësonte progresin e Kosovës në përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit sipas Nenit 80 të MSA në ndërtimin e një mbikëqyrje efektive të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve, e cila ndikon në klimën sociale dhe rritjen ekonomike. Nevoja shtesë për harmonizim me Ligjin e ri për inspektime dhe mangësitë e evidentuara në Ligjin ekzistues do të ndikonin negativisht në kuptimin dhe zbatimin e ligjeve të tjera të ndërlidhura që u hartuan pas këtij Ligji dhe më e rëndësishmja, i gjithë sistemi i Kosovës për zbatimin e legjislacionit për produktet jo ushqimore do të mbetet jo-transparent dhe jo koherent.

### **3.2: Opsioni 2 - Miratimi i Ligjit të ndryshuar për Kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësim të konformitetit dhe përmirësimi i zbatimit të tij**

Opsioni 2 shqyrton mundësitë për adresimin e mangësive kryesore të sistemit të mbikëqyrjes së tregut, pra ndryshimi i Ligjit ekzistues. Kjo do të siguronte zbatimin e ligjit të harmonizuar me *acquis-in* e fundit të BE-së dhe zbatimin e ligjit përmes gjykatave të cilat do të mund ta përdornin jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Kjo do të mundësonte edhe trajnime të vazhdueshme të përditësuar për inspektorët dhe fushata të ndërgjegjësimit që synojnë komunitetin e biznesit si dhe konsumatorët/përdoruesit e fundit.

Kjo qasje nuk është pa të meta pasi që BE-ja e ka rregulluar kornizën e gjerë horizontale për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së produkteve me një bazë ligjore për 70 akte të cilat mbulojnë grupe të caktuara të produkteve, siç mund të shihet në Shtojcën 1 të Rregullores së BE-së 2019/1020.

Nëse e krahasojmë këtë fushëveprim me fushëveprimin e legjislacionit të Kosovës për produkte, e shohim këtë fushë të mbuluar. Ajo përfshinë së paku ligjet parësore në vijim të Kosovës:

- Ligji nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit,
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikatet,
- Ligji nr. 06/L-037 për Metrologji,
- Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike,
- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat,
- Ligji nr. 05/L-132 për Automjete,
- Ligji nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor,
- Ligji nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit,
- Ligji nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion,
- Ligji nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë,
- Ligji nr. 04/L-190 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Mjekësore,
- Ligji nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga zjarri,
- Ligji nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve

Është e qartë se fushëveprimi i Rregullores (BE) 2019/1020 është shumë i gjerë për t'u transpozuar si kapitull i një ligji parësor i cili trajton vetëm disa nga grupet e produkteve të cilat mbulohen nga Rregullorja. Ekziston një nevojë thelbësore për një ligj primar të përgjithshëm të pavarur mbi rregullat e mbikëqyrjes së tregut, i cili do të mbulonte në të njëjtën mënyrë të gjitha produktet e mbuluara nga një numër i madh ligjesh materiale të përshkruara më sipër.

### **3.3: Opsioni 3 - Miratimi i Ligjit të ri për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve**

Zgjedhja e opsionit 3, do të lehtësonte dhe mbështeste progresin e Kosovës në përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit sipas nenit 80 të MSA në ndërtimin e një mbikëqyrje efektive të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve. Marrë për bazë dispozitat që ndodhen në ligje apo akte të ndryshme nënligjore të përmendura tek opsioni 2, të cilat mbulojnë grupe të ndryshme të produkteve janë në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe gjithashtu mund të kenë kontradikta përbrenda të njëjtit akt juridik. Kontradiktat e tilla shkaktojnë jo koherencë dhe pasiguri ligjore. Prandaj, ato duhet të unifikohen sa më shumë që të jetë e mundur. Përkufizimet që aplikohen në këtë ligj dhe

kushtet që i përcakton ky ligj, duhet të formulohen saktësisht. Autoriteti rregullator (MINT) duhet të ndjek me kujdes strukturën e propozuar për ligjin e ri dhe mekanizmat e përshkruar në Kapitullin 1 duke mos lejuar devijime. Formulimi i qartë në ligjin e ri duhet të shpjegojë se si do shtjellohen dhe zgjidhen këto çështje dhe kush janë akterët e rinj përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të ri.

Kur mangësitë dhe jo koherencat në kornizën aktuale rregullatore janë shkak i problemit, ashtu si në këtë rast, hartimi i një akti të ri ligjor horizontal është opsioni i rekomanduar për të zgjidhur problemin. Analiza e problemit tregon qartë se mungesa e ligjit adekuat është shkak i vërtetë i problemit. Për më tepër, analiza tregon se problemi nuk mund të zgjidhet me përshtatjen e kornizës ekzistuese ligjore. Kjo çështje është përshkruar në detaje në Planin e Veprimit: Transpozimi dhe Zbatimi i: Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores së BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave, i miratuar me Vendimin Nr.19/89, Dt.20.07.2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për t'u përafuar plotësisht me Rregulloren (BE) 2019/1020, autoriteti rregullator duhet të shqyrtojë mundësinë e miratimit të “Ligjit për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve” duke krijuar një qasje koherente dhe harmonizim të dispozitave me Ligjin e ri për Inspektime, e me të cilin do të krijohet korniza ligjore horizontale për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve. Natyra horizontale e akteve ligjore themelore (më shumë se 15 ligje themelore të Kosovës për grupet e produkteve joushqimore do të mbulohen) kërkojnë një ligj të veçantë për mbikëqyrjen e tregut të produkteve<sup>7</sup> i cili vendos një kornizë horizontale për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve.

Në kuadër të opsionit 3, MINT duhet të organizojë vazhdimisht trajnime dhe aktivitete të tjera për inspektorët kompetentë dhe për zyrtarë të tjerë shtetëror. Kjo vlen gjithashtu edhe për odat ekonomike, të cilat përfaqësojnë interesat e biznesit, por edhe për shoqatat e konsumatorëve.

Duhet të ritheksohet që efekti i trajnimeve dhe fushatave vetëdijësuese do të ishte i kufizuar pa një Ligj të ri. Edhe nëse bëhen përmirësime në ligjin ekzistues (Opsioni 2), sërish do të nevojiteshin trajnime dhe fushata të vetëdijësimit. Sidoqoftë, ndikimi i tyre do të ishte më efektiv me Ligjin e ri për Inspektimet e përputhshmërisë së produkteve.

Prandaj, **Opsioni 3** paraqitet si opsion i duhur i politikës për të shtjelluar problemin kryesor të identifikuar në këtë dokument, gjegjësisht, kërkesa për harmonizimin uniform të legjislacionit të BE-së për zbatimin dhe futjen në fuqi të rregulloreve teknike në fushëveprimin e plotë të Rregullores (BE) 2019/1020. Kjo do të bëhet duke i përcaktuar kompetencat e inspektorateve kompetente për mbikëqyrjen e grupeve të ndryshme të produkteve jo ushqimore dhe në të njëjtën kohë duke përmirësuar dhe modernizuar sistemin e mbikëqyrjes së tregut në mënyrë transparente dhe koherente.

Referuar dokumentit “Planit të Veprimit: Transpozimi dhe Zbatimi i: Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores së BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave, i miratuar me Vendimin Nr.19/89, Dt.20.07.2022

---

<sup>7</sup> Me qëllim të arritjes së koherencës me Ligjin nr. 08/L-067 për Inspektimet, titulli i rekomanduar i ligjit parësor do të ishte “Ligji për Inspektimet e Pajtuëshmërisë së Produkteve”

nga Qeveria e Republikës së Kosovës”, kompetencat e inspektorateve në lidhje me produktet të cilat i mbikëqyrin janë ndarë si në vijim:

“Inspektorati Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut kryen mbikëqyrje inspektuese në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera në lidhje me:

- përmbushjen e standardeve të mallrave dhe të shërbimeve pas hyrjes së tyre në treg
- sigurinë e produkteve në treg
- mbrojtjen e konsumatorit”

Mund të shihet qartë se Ligji rregullon që përputhshmëria dhe siguria e të gjitha produkteve në treg duhet të mbikëqyret nga Inspektorati i Tregut. Kjo do të thotë që Kosova në vitin 2010 vendosi të ketë mbikëqyrje të centralizuar në mënyrë rigorozë të produkteve industriale të cilat ishin vendosur në tregun e Republikës së Kosovës. Por analiza e kompetencave ekzekutuese para përgatitjes dhe miratimit të Rregullores (QRK) nr. 24/2020 Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese tregoi një situatë thellësisht ndryshe. Sipas gjetjeve, situata ishte siç tregohet më poshtë (kompetencat më të rëndësishme):

- Pajisjet elektrike (Inspektorati i Tregut),
- Makineri (Inspektorati i Tregut)
- Pajisjet nën presion, (Inspektorati i Energjisë)
- Mjetet motorike (Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i Automjeteve),
- Radio pajisjet (ARKEP),
- Eksploziv për përdorim civil dhe artikujt piroteknikë (Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike, Inspektorati),
- Produktet e ndërtimit (Inspektorati i Tregut në treg, Inspektorati i Ndërtimit në punimet e ndërtimit),
- Pajisjet farmaceutike dhe mjekësore (Inspektorati Farmaceutik),
- Produktet e lidhura me energjinë - eko-dizajni dhe etiketimi i energjisë (Inspektorati i Energjisë),
- Kimikatet (Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit),
- Teleferikët dhe barkat rekreative (Ministria e Infrastrukturës, Inspektorati i Infrastrukturës),
- Kozmetika (Inspektorati Farmaceutik)
- Produktet në kuadër të kërkesave e Sigurisë së Përgjithshme të Produkteve (Inspektorati i Tregut, përveç produkteve mashtruese dhe produkteve që vijnë në kontakt me lëkurën e njeriut dhe/ose ushqimin dhe paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e njeriut, të cilat janë nën përgjegjësinë e Inspektoratit sanitar).

Trupi Koordinues ekzistues për Mbikëqyrjen e Tregut duhet të qëndrojë në legjislacionin e ardhshëm për përputhshmërinë e produkteve me përfshirjen e IP si kryetar. Të dyja palët u pajtuan që Zyra e vetme ndërlidhëse të vendoset në kuadër të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm e cila do t'i kryej detyrat e saj ndërlidhëse si njësi e ngarkuar me bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe Doganës dhe të shkëmbimit të informacioneve për aktivitetin e inspektimit.

Platforma elektronike ekzistuese RAPEX-Kosova dhe ICSMS (Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit) i cili është kërkesë nga Rregullorja (BE) 2019/1020, do të funksionojnë sipas pikës 1.3 të këtij Koncept Dokumenti.

Qeveria e Rrepublicës së Kosovës përmes autoriteteve rregullatore duhet të kenë parasysh se do të paraqitet obligimi edhe për ngritjen e Qendrës Kosovare **SOLVIT** para anëtarësimit në BE dhe të fillojnë përgatitjet me kohë. Gjëja e dytë e rëndësishme është vendosja e Qendrës në një institucion të duhur që është i lidhur mirë dhe me ndikim. “Tregtia dhe shërbimet” nuk janë fusha më e rëndësishme apo më e madhe e punës së Qendrës. Në fokus të punës së saj janë më tepër fushat e njohjes së kualifikimeve profesionale, të drejtat e qëndrimit, përfitimet familjare dhe të drejtat pensionale.

Autoritetet rregullatore duhet të kenë parasysh se do të kenë për obligim ta krijojnë sistemin e **Portës së Vetme Dixhitale të Kosovës** (SDG) dhe ta emërojnë një koordinator kombëtar para anëtarësimit në BE dhe t'i fillojnë përgatitjet me kohë. Gjëja e dytë e rëndësishme është vendosja e koordinimit të sistemit të PVD-së në një institucion të duhur që është i lidhur mirë dhe me ndikim tek autoritetet. “Të drejtat/Mallrat e konsumatorit” nuk janë e vetmja fushë e rëndësishme apo e konsiderueshme e punës së Qendrës. Ekzistojnë edhe fushat e pensionit, arsimit, punësimit dhe kujdesit shëndetësor që janë në fokus të sistemit të PVD-së dhe portaleve të rrjetit të tij.

## **Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen**

Tabela më poshtë rendit ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Aneksat 1 deri 4 tregojnë vlerësimin e të gjitha ndikimeve ekonomike, sociale, mjedisore por edhe ndikimet në të drejtat themelore. Këto ndikime paraqiten në Doracakun për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve. Të katër anekset gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

*Tabela 6 Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara sipas kategorisë së ndikimit*

<b>Kategoria e ndikimeve të mundshme</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>	<b>Opsioni 3</b>
<b>Ndikimet ekonomike</b>	Ndikimi negativ pasi tregu nuk është plotësisht funksional	Ndikim i kufizuar, përmirësim relativisht i vogël i efikasitetit të sistemit të pandryshuar.	Rritja e efikasitetit të mbikëqyrjes së tregut të produkteve të konsumit jep sinjal pozitiv për ekonominë.
<b>Ndikimet sociale</b>	Të drejtat e konsumatorëve individual dhe familjarë pengohen nga <i>status quo</i> -ja, i cili nuk është në nivelin e kërkuar	Të drejtat e konsumatorëve individual dhe familjarë përmirësohen pak nga zbatimi më i mirë, i cili ende nuk është në nivelin e kërkuar	Të drejtat e konsumatorit individual dhe familjarë përmirësohen me zbatimin më të mirë të rregullave më të qarta, të cilat janë në nivelin e duhur
<b>Ndikimet mjedisore</b>	Pa ndikim	Ndikim i vogël	Ndikim pozitiv
<b>Ndikimet në barrën administrative</b>	Barra administrative mbetet e pandryshuar në <i>status quo</i> për nga organizimi i mbikëqyrjes së produkteve në treg	Barra administrative mbetet e pandryshuar në <i>status quo</i> për nga organizimi i mbikëqyrjes së produkteve në treg	Barra administrative është zvogëluar për shkak të organizimit të përmirësuar të mbikëqyrjes së produkteve në treg
<b>Ndikimi në NVM</b>	Pa ndikim për NVM	Ndikimi i pamjaftueshëm për NVM në eliminimin e praktikave të padrejta tregtare	Ndikimi pozitiv në NVM për shkak të përmirësimit të organizimit dhe zbatimit të mbikëqyrjes së produkteve në treg duke eliminuar praktikën e padrejta tregtare
<b>Ndikimi në buxhet</b>	Opsioni 3 ka kosto buxhetore të kufizuara dhe ndikon në buxhetin vjetor të Kosovës.		

#### **4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave**

Nuk janë hasur vështirësi gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti për sa i përket mbledhjes së të dhënave dhe informatave tjera relevante. Grupi punues ka marrë për bazë të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në “Planin e Veprimit: Transpozimi dhe Zbatimi i Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve dhe Rregullores së BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave, i miratuar me Vendimin Nr.19/89, Dt.20.07.2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës”.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në përputhje me Rregulloren 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, ky proces kryhet përmes metodave të ndryshme, përfshirë Platformën Elektronike për Konsultimet Publike dhe përmes takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesit, me të gjitha institucionet dhe kategoritë e shoqërisë, qofshin ato me nivele të larta interesi ose ata që mund të japin kontributin e tyre për shqyrtimin e opsioneve. Kontribute të rëndësishme mund të jepen prej të gjitha kategorive të bizneseve, institucioneve të Kosovës që u shërbejnë bizneseve dhe konsumatorëve, odave ekonomike me anëtarë nga radhët e bizneseve dhe ekspertët e projekteve të ndryshme ndërkombëtare për asistencë teknike.

***Tabela 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të realizuara për koncept dokumentin***

Procesi i konsultimit synon:						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të merr të gjitha pikëpamjet nga palët që kanë qenë dhe janë përfshirë në zbatimin e ligjit ekzistues, duke filluar nga problemet, efektet që janë shkaktuar në praktikë si dhe ndryshimet që duhet të përfshihen për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.</li> </ul>						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/ Njoftimi	Afati kohor	Buxheti	Personi përgjegjës
Takimi brenda institucional	Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të punës	Finalizimi i draftit të parë të Koncept Dokumentit	Komunikimi përmes postës elektronike për organizimin e takimeve	Dhjetor 2022		Gurakuq Kastrati
Takimet e grupit punues për hartimin e Koncept Dokumentit	Anëtarët e grupit punues për hartimin e Koncept Dokumentit	Grup punues shqyrton draftin e parë të Koncept Dokumentit	Komunikimi përmes postës elektronike për organizimin e takimeve	21.07.2022 14.09.2022 03.11.2022 04.11.2022 05.11.2022		



Takim i hapur për të gjithë palët e interesit	Të gjitha palët e interesit	Takim publik për të prezantuar draftin e parë të Koncept Dokumentit	Komunikimi përmes ueb faqes së Ministrisë, njoftimit për shtyp dhe postës elektronike	xx.yy.2022		
Konsultimi preliminar ndërministror	Ministritë dhe agjencitë përkatëse të linjës	Shpërndahet drafti i parë i plotë	Komunikimi përmes postës elektronike; drafti është së paku në dy gjuhë	11 Janar 2023 – 1 Shkurt 2023		
Konsultime publike	Të gjithë hisedarët	Publikimi i konsultimeve në portalin për konsultim publik	Publikimi në ueb faqe; njoftimi me email dhe media sociale	03 Mars 2023 - 24 Mars 2023		
Takimi i Grupit të Punës	Anëtarët e grupit punues	Finalizimi i koncept dokumentit	Dorëzimi i Koncept Dokumentit për miratim në Qeveri	16.02.2023 22.02.2023		

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Duke pasur parasysh që opsionet janë paraqitur në detaje në Kapitullin 3, kjo pjesë do të trajtojë shkurtimisht përparësitë dhe mangësitë e opsioneve në kontekst. *Opsioni "Pa ndryshim"* nuk është i pranueshëm pasi që ka ndryshuar legjislacioni relevant i BE-së.

Veprimet në kuadër të *Opsionit 2* përmirësojnë zbatimin e Ligjit të ndryshuar për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, por efektiviteti i tyre është jo adekuat pasi që Ligji nuk i mbulon të gjitha grupet e produkteve që mbulohen me Rregulloret (BE) 2019/1020 dhe 2019/515.

Prandaj, ***opsioni 3 mbetet opsioni më i përshtatshëm për t'i rritur gjasat e rregullimit dhe zbatimit më të mirë të tregut të produkteve jo-ushqimore.***

### 6.1: Krahasimi i tri opsioneve

Për ta shtjelluar problemin e paraqitur në këtë analizë, janë shqyrtuar tri opsione:

- opsioni pa ndryshim, sipas të cilit situata aktuale dhe, rrjedhimisht, vështirësitë e paraqitura në praktikë do të vazhdojnë;
- opsioni i ndryshimeve në zbatimin e Ligjit ekzistues të ndryshuar për Kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit;
- pasuar nga opsioni i tretë i cili përfshin ndryshime të mëdha legjislative si hartimi i Ligjit për Inspektimet e përputhshmërisë së produkteve me qëllim të koordinimit të përmirësuar të punës mes inspektorateve dhe Autoritetit Doganor, mbikëqyrje e përforcuar e tregtisë përmes internetit, nxitja e operatorëve ekonomik për aktivitete të përbashkëta me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për t'i identifikuar produktet e rrezikshme dhe në mos përputhshmëri në treg dhe për t'i ndërmarrë masat e duhura për eliminimin e mangësive formale apo masa korigjuese – zakonisht me largimin ose tërheqjen e produkteve nga tregu.

**Tabela 8 Krahasimi i opsioneve**

	<b>Metoda e krahasimit: Analiza shumë-kriterëshe (ASHK)</b>		
<b>Opsionet</b>	<b>Opsioni 1: Pa ndryshime</b>	<b>Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit të LKTP të ndryshuar<sup>8</sup></b>	<b>Opsioni 3: Hartimi i Ligjit për Inspektimet e pajtueshmërisë së produkteve</b>
<b>Rezultati pozitiv relevant</b>	Nuk ka kosto të mëtejshme për rritjen e efektivitetit dhe ndërgjegjësimin për sistemin e sigurisë së produktit	Rritja e aktivitetit të inspektorëve dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve për nivelin e lartë të sigurisë së disa grupeve të produkteve joushqimore.	Gjenden dhe tërhiqen nga tregu një numër më i madh i produkteve të papajtueshme ose të rrezikshme - sistem koherent i inspektimeve për të

<sup>8</sup> Ligji për Kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit

	– por rregullat nuk janë përditësuar				gjitha grupet e produkteve joushqimore.				
<b>Rezultatet negative relevante</b>	Vazhdojnë mangësitë ligjore dhe zbatimi joefektiv i ligjit			Zbatim më i mirë i ligjit në krahasim me opsionin <i>status quo</i> ; megjithatë, ligji i ndryshuar nuk mbulon të gjitha grupet e produkteve joushqimore			Rezultati negativ minimal nëse zbatimi i rregullave të përditësuara është joefektiv		
<b>Kostot relevante</b>	Nuk ka kosto shtesë			Kosto financiare shtesë me rregulla dhe zbatime të kufizuara të përmirësuara			Kosto financiare shtesë me rregulla dhe zbatime të përmirësuara		
<b>Vlerësimi i ndikimit të pritur në buxhet</b>	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
				x	x	X	x	x	x
<b>Përfundimi</b>	Nuk ka përfitime dhe nuk ka kosto			Ofron përfitime të vogla pozitive me një kosto më të lartë			Ofron përfitime të mëdha me kosto të përshtatshme		

## 6.2. Plani i zbatimit për opsionin e preferuar

Duke pasur parasysh përshkrimin e hollësishëm të sfidave që Opsioni 3 synon të shtjellojë, si dhe përfitimet pasuese nëse miratohet opsioni 3, kjo pjesë përqendrohet në planin e zbatimit për hartimin e Ligjit të veçantë për Inspektimet e Pajtushmërisë së Produkteve me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe modernizimit të mbikëqyrjes së produkteve.

*Tabela 9: Plani i Zbatimit për Opsionin 3: Hartimi dhe zbatimi i Ligjit për Inspektimin e Pajtushmërisë së Produkteve*

<b>Qëllimi i politikës</b>	Arritja e nivelit të lartë të përputhshmërisë dhe sigurisë për produktet joushqimore në tregun e Republikës së Kosovës – qëllimi është që vetëm produktet e përputhshme dhe të sigurta mund të vendosen në treg.	Shifra e vlerësuar e koston
<b>Objektivi strategjik</b>	Përafrimi i metejmë i kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit.	
Objektivi specifik 1:	Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata / departamenti përgjegjës	
	Miratimi i Ligjit për Inspektimin e Pajtushmërisë së Produkteve	

Dispozitat për inspektimin e pajtueshmërinë dhe sigurinë e produkteve të harmonizuara me acquis të BE të cilat zbatohen për të gjitha produktet jo ushqimore;	Produkti 1									
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni përgjegjës		
		Themelimi i grupit punues dhe hartimi i ligjit	x	x					MINT <sup>9</sup>	5000
		Konsultimet ndërministrrore	x	x					MINT	500
		Konsultimi publik përmes platformës përkatëse online	x						MINT	
		Përgatitja e materialeve për miratim të Qeverisë	x	x					MINT	500
		Informimi i palëve të interesit lidhur me ligjin		x	x				MINT	10000
Pikësnyimi specifik 2: Ndërtimi i një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm për autoritetet e mbikëqytjes së tregut;	Produkti 2	Miratimi i legjislacionit sekondar, ngritja e vetëdijes dhe publikimi i standardeve të harmonizuara sipas legjislacionit sektorial për grupet e produkteve								
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5			

<sup>9</sup> Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese		x				MINT(DI C) dhe TKMT <sup>10</sup>	1500
	Miratimi i Rregullores për grupet specifike të produkteve që mund të vendosen në treg vetëm nëse operatori ekonomik i cili furnizon me ato produkte është i themeluar në Republikën e Kosovës		x				MINT DIC	1000
	Miratimi i Vendimit për themelimin e zyrës ndërlidhëse si njësi e ngarkuar me bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe Doganës		x	x			MINT/IQ MT	500
	Hartimi i Strategjisë për		x	x			MINT (IQMT),	10000

<sup>10</sup> Trupi Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut

	Mbikëqyrjen e Inspektimit të Produkteve e cila do të miratohet nga Qeveria						TKMT, Ministritë e Linjës	
	Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore të veprimit sektorial dhe planit të përgjithshëm të veprimit për mbikëqyrjen e inspektimit të produkteve i cili do të miratohet me qëllim të zbatimit të strategjisë për mbikëqyrjen e inspektimeve;				x	x	MINT (IQMT)+ TKMT,	3000
	Aktivitete të shtuara të autoriteteve të mbikëqyrjes së inspektimeve në komunikim me operatorët ekonomikë		x	x	x	x	MINT/IQ MT	1500
	Miratimi i Vendimit për themelimin e Pikës e Kontaktit për Produkte e cila do të ofrojë informata online për kërkesat ligjore për tregtimin e produkteve, dhe funksionalizimi i		x	x			MINT DIC	17286

		saj(përfshirë pajisje dhe inventar)							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
Pikësnyimi specifik 3:Rritja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik dhe autoriteteteve të mbikëqyrjes së tregut në ngritjen e nivelit të përputhshmërisë dhe sigurisë së produkteve në treg;	Produkti 3								
		Funksionalizimi i zyrës ndërlidhëse për mbikëqyrjen e tregut(përfshirë pajisje dhe inventar)		x	x	x	x	MINT (IQMT)+ TKMT, Ministrinë e Linjës	17286
Pikësnyimi specifik 4: Rritja e vetëdijes së bizneseve dhe konsumatorëve/përdoruesve të fundit në lidhje me pajtueshmërinë dhe sigurinë e produkteve;	Produkti 4		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
		Informimi i palëve të interesit dhe ngritja e vetëdijes		x	x	x	x	MINT (IQMT)+ TKMT, Ministrinë e Linjës	1,000
Pikësnyimi specifik 5: Inkurajimi i përdorimit të standardeve teknike për ta arritur një nivel të lartë të sigurisë dhe pajtueshmërisë së produkteve.	Produkti 5		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
		Informimi i vazhdueshëm palëve të interesit për përputhshmërinë e produkteve, përmes punëtorive, spoteve		x	x	x	x	MINT (IQMT)+ TKMT, Ministrinë e Linjës	10,000

		televizive, takimeve publike.							
--	--	----------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

## Kapitulli 7: Përfundimi dhe hapat e ardhshëm

Bazuar në të gjitha gjetjet e lartcekura, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si hartuese e këtij Koncept Dokumenti i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratoj opsionin 3, me të cilin propozohet hartimi i Ligjit të ri për Inspektimin e Përputhshmërisë së së Produkteve me një ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e nenit 2 të Ligjit për Inspektimet.

Sikurse është argumentuar në këtë Koncept Dokument, në këtë fazë të zhvillimit të rendit ligjor të Kosovës ende ka paqartësi lidhur me ndarjen e kompetencave ndërmjet autoriteteve inspektuese në fushën e përputhshmërisë së produkteve. Nuk ka ndarje të qartë, specifike të kategorive të ndryshme të produkteve dhe rrjedhimisht ka mbikëqyrje jo efektive në treg.

Prandaj, ndryshimet që propozohen në opsionin 3 do të shërbejnë si një mjet për rritjen dhe përmirësimin e aktiviteteve të inspektimit të produkteve në sistemin koherent të organizimit të organeve inspektuese të themeluara me Ligjin për Inspektimet.

Ligji do të krijojë një mjedis më të përshtatshëm për parandalimin dhe eliminimin e vendosjes së produkteve të papërputhshme në treg, do të ndihmoj autoritetet në luftimin e praktikave të padrejta tregtare, do të mbroj sigurinë dhe të drejtat e konsumatorëve si dhe do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë do të ndër marrë procedurat e nevojshme për të hartuar ligjin, në përputhje me parimet dhe zgjidhjet e propozuara.

### 7.1: Dispozitat për monitorim dhe vlerësim

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ligji i ri pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës deri në fund të vitit 2023 ose fillimin e 2024 dhe të hyj në fuqi gjashtë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Harmonizimi me rregullat e BE-së dhe efikasiteti i mbikëqyrjes së vendosur të inspektiveve lidhur me produktet do të monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht përmes përditësimeve në PKZMSA dhe takimeve vjetore në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit.



## Aneksi 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik<sup>11</sup>

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë / i ulët	I lartë / i ulët	
Vendet e punës <sup>12</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	X			I ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ndikojë në lehtësinë e gjetjes së punës?		x			
Të bërit biznes	A do të ndikojë në qasjen në financa për bizneset?		x			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?	x		I ulët	I ulët	
	A do të lejohen produkte të caktuara në treg?		x			
	A do të mbyllen bizneset?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		x			
Barra administrative	A parashihen obligime që bizneset të ofrojnë informata të reja?		x			
	A është thjeshtëzuar obligimi për të ofruar informatat e biznesit?	x		I lartë	I ulët	
Tregtia	A pritet të ndryshojnë rrjedhat aktuale të importit?		x			
	A pritet të ndryshojnë rrjedhat aktuale të eksportit?		x			
Transporti	A do të ndikojë në mënyrën e transportimit të udhëtarëve dhe / ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të		x			

<sup>11</sup> Legjislacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët

<sup>12</sup> Kur ndikon në vendet e punës, do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	transportuar udhëtarë dhe / ose mallra?					
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në aktivitete të reja?	x		I ulët	I ulët	
	A pritet që kompanitë të anulojnë ose shtyjnë investimet për më vonë?		x			
	A do të rriten investimet e Diasporës?		x			
	A do të ulen investimet e Diasporës?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi afarist i produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulët çmimi i inputeve të biznesit, siç janë energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa të nxiten inovacioni dhe kërkimi?		x			
	A ka gjasa të pengohen inovacioni dhe kërkimi?		x			
Ndikimi në NVM-të	A janë NVM-të kryesisht në mesin e ndërmarrjeve të prekura?	x		I lartë	I ulët	
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve që janë në dispozicion për bizneset apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për bizneset apo konsumatorët?	x		I ulët	I ulët	
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të preket ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	x		I ulët	I ulët	
	A është i përqendruar ky sektor në ndonjë rajon të veçantë?		x			

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet në rritjen e ardhshme ekonomike?	x		I ulët	I ulët	
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

## Aneksi 2: Formulari i vlerësimit të ndikimeve sociale <sup>13</sup>

Kategoria e ndikimit social	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë / i ulët	I lartë / i ulët	
Vendet e punës <sup>14</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x		I ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A preken vendet e punës në një sektor të veçantë biznesi?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Ndikimet sociale rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në ndonjë rajon ose qytet të veçantë?		x			
Kushtet e punës	A preken të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet e punës në kushte të rrezikshme? (parashihen standarde më të mira)	x		I lartë	I ulët	
	A do të ketë ndikim në mënyrën e dialogut shoqëror ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve?		x			
Përfshirja sociale	A do të ndikojë në varfëri?		x			

<sup>13</sup> Legjislacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët

<sup>14</sup> Kur ndikon në vendet e punës, do të ketë edhe ndikimet ekonomike.

	A do të ketë ndikim në qasjen në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ketë ndikim në financimin ose organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Edukimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		x			
	A do të ketë ndikim në trajnimin profesional?		x			
	A do të ketë ndikim në aftësimin e punëtorëve dhe shkollimin gjithë jetësor?		x			
	A do të ketë ndikim në organizimin ose strukturën e sistemit arsimor?		x			
	A do të ketë ndikim në lirinë dhe vetëqeverisjen akademike?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në larminë kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A preken mundësinë për personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë apo të përfitojnë nga aktivitetet kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin demokratik?		x			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x		I lartë	I ulët	I ulët

	A do të informohet publiku më mirë për çështje të caktuara?	x		I lartë	I ulët	I lartë
	A ndikon opsioni në mënyrën e funksionimit të partive politike?		x			
	A do të ketë ndikim në shoqërinë civile?		x			
Shëndeti dhe siguria publike	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç janë jetëgjatësia apo norma e vdekshmërisë?		x			
	A do të ndikojë në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet ose zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme? (zvogëlohet)	x		I lartë	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës ose cilësisë së ajrit, ujit dhe / ose tokës?	x		I lartë	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	x		I lartë	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në hedhjen e mbeturinave?		x			
	A do të ketë një ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë niveli i interesimi për sportet, ndryshimet ushqimore ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe specifike që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerët (që përcaktohet nga faktorët siç janë mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grupi shoqëror ose rajoni)?	x		I lartë	I ulët	

Krimi dhe siguria	A ka mundësi të preken kriminelët?		x			
	A preket fitimi i mundshëm nga krimi?		x			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		x			
	A ka ndikim në kapacitetin e zbatimit të ligjit?	x		E lartë	E ulët	
	A ka ndonjë ndikim në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

### Aneksi 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit mjedisor <sup>15</sup>

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ndikojë në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj)?	x		E lartë	E ulët	
	A do të ketë ndikim në konsumin e karburantit?		x			
	A do të ndryshojë larmia e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmimet e produkteve që janë miqësore për mjedisin?	x		E ulët	E ulët	
	A do të jenë më pak ndotëse aktivitete të caktuara?	x		E ulët	E ulët	
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?	x		E ulët	E ulët	
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujit të ëmbël?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe përdorimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (siç janë acidifikimi, ndotja, përdorimi i pesticideve ose herbicideve)?		x			
	A do të ndikojë në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbasë terreni (përmes ndërtimeve, etj.)?		x			
	A do të rikuperohet toka (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			

<sup>15</sup> Legjislacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët



	A do të ketë ndonjë ndryshim në përdorimin e tokës (p.sh. nga përdorimi pyjor në përdorim bujqësor ose urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat e trajtimit të mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësinë për riciklimin e mbeturinave?	x		I ulët	I ulët	
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervat e peshkut, energjia hidrike, energjia diellore, etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve jo të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri, etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat e rreziqeve, të tilla si zjarre, shpërthime ose aksidente?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ndikojë opsioni në gatishmërinë në rast të katastrofave natyrore? A preket mbrojtja e shoqërisë nga katastrofat natyrore?		x			
	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura ose të rrezikuara ose në zonat ku ata jetojnë?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të preken madhësia ose lidhjet ndërmjet zonave natyrore?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
	A do të ketë ndikim në trajtimin e kafshëve?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të preket shëndeti i kafshëve?		x			
			x			

	A do të preket cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			
--	--	--	---	--	--	--

## Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit në të drejtat themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë / i ulët	I lartë / i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, të drejtën e tyre për jetë apo integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x			
	A ndikon opsioni i privatësisë në privatësinë e një personi?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar një familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose sociale të individëve ose familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x			
	A ndikon në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit apo asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		x			
	A janë të garantuara të drejtat e individit në qasje, korrigjim dhe kundërshtim?	x		I lartë	I lartë	
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x		I lartë	I lartë	

Azili	A ndikon opsioni në të drejtën për azil?		x			
Te drejtat pronësore	A do të preken të drejtat pronësore?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e të bërit biznes?		x			
Trajtim i barabartë	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x		I lartë	I lartë	
	A ka gjasa që grupe të caktuara, të cilat preken në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, mendimit politik ose mendimit tjetër, moshës ose orientimit seksual) të preken në mënyrë direkte apo indirekte?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të ndërlikuara?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, qasja në ndonjë dosje, etj.)?	x		I lartë	I ulët	
	Për ligjin penal dhe për dënimet e parapara: a preken të drejtat e të pandehurit?		x			
	A preket qasja në drejtësi?		x			